



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional “Ndhmës
Dentar”
i Institucionit të Arsimit të Lartë
Kolegji Universitar “REALD”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Ramazan Isufi

2. Prof. Asoc. Nazmi Koci

Janar/ 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për programin e studimit: Program me karakter profesional në “Ndhmës Dentar”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “REALD”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Stomatologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program me karakter profesional në “Ndhmës Dentar”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Nr. 391, datë 10.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Është program i ri
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i paë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	13/1
18	Numri i studentëve:	38
19	Komente / të tjera:	-

Naxmi Koci
Shqipëri

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës;

Programi i studimit “Ndhmës Dentar” është organizuar nga IAL, Kolegji Universitar REALD në Vlorë, në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”.

Programi i studimit me karakter profesional “Ndhmës Dentar” është hapur me Urdhër Nr.391, datë 10.07.2018 të Ministrit Arsimit Sportit dhe Rinisë.

Ky program zhvillohet nga Departamenti i Stomatologjisë në Fakultetin e Shkencave Mjekësore i cili u ofrohet studentëve të interesuar për të ndërtuar karrierën e tyre profesionale si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat të fushës së Stomatologjisë. Ky program ka si qëllim të formojë një figurë profesionale e cila ofron dijet dhe aftësite e veta në mbrojtje të shëndetit të qytetareve.

Megjithatë ngopjen e tregut me profesionistë të tillë mendojmë se përgatitja e “Ndhmës Dentarëve” mund të jetë një ndihmesë e cmuar në tregun e Stomatologjisë, për të cilën tregu i punës do të bëjë seleksionimin e këtyre profesionistëve në të ardhmen. Ndonëse tregu i shërbimit Stomatologjik ka një mbingopje me specialist që kanë kryer studime të integruara në këtë fushë, problem i kuadrit ndihmës dhe asistencës në këtë sektor mbetet ende i pa zgjidhur.

Persa i përket emërtimit GVJ mendojmë se do të ishte më mirë “Asistent Dentar”

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit me karakter profesional “Ndihmës Dentar” është bërë nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) i ngritur nga ASCAL me 17.09.2020, Nr.92/11 prot. i cili ka përgatitur Raportin në përputhje me rubrikat e parashikuara në modelin e RVJ të hartuar nga ASCAL dhe miratuar nga Bordi i Akreditimit.

Vlerësimi i jashtëm është bërë duke marrë në konsideratë përpunimin e të dhënave të marra nga drejtuesit e këtij programi, personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, anketimet e studentëve, programet mësimore, personelin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, me personelin e zyrës së burimeve njerëzore, personeli për këshillimin e karrierës dhe kërkimit shkencor, regjistrat në sekretarinë mësimore si dhe infrastrukturën mbështetëse (sallat e leksioneve, seminarëve, laboratorëve, praktikave, biblioteka me literaturën perkatëse, etj).

Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. As Nazmi Koci dhe Prof. Dr. Ramazan Isufi. Gjatë këtij procesi vlerësimi GVJ është asistuar nga Erion Xhako dhe Aviola Bardhi, Koordinator Teknike të ASCAL.

Grupi u njoh dhe shqyrtoi dosjen e vetvlerësimit duke u ndalur posaçërisht tek Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB). Njohja dhe studimi i dosjes çoi në formulimin e pyetjeve që lidhen me nevojën për qartësimin e gjetjeve në RVB, saktësimin e vlerësimeve, plotësimin e informacioneve dhe konkretizimin e paraqitjeve. Për të realizuar këto objektiva, GVJ zhvilloi një vizitë dy ditore në datat 7 e 8 Tetor 2020 në këtë institucion dhe verifikoi të gjitha deklaratimet e bëra, e përmbajtjen e dokumentacionit të paraqitur dhe kushtet reale të realizimit të programit. Pas këtyre u hartua ky RVJ.

Koordinatori Teknike e ASCAL deri në hapin e vizitës ishte Z. Erjon Xhako, më pas procedura i kaloi Znj. Aviola Bardhi.

Më datë 13.01.2021, përmes sistemit AMS, KU “Reald” është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm dhe me shkresë Nr. Prot, 20, datë 13.01.2021. Më datë 18.01.2021, KU “Reald” përcjell shkresën me Nr. Prot, 15, datë 14.01.2021 me të cilën shpreh dakordësinë me përmbajtjen e tij.

Draft- Raporti kthehet në Raport përfundimtar.

Nazmi Koci
Aviolas



Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Ndihmës Dentar”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Organizimi dhe permbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat dhe strategjinë afatshkurter të IAL. Programi i studimit me karakter profesional “Ndihmës Dentar” është konceptuar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të IAL me standartet ndërkombëtare si dhe ato të vendit të tyre. Ky program është përfshirë në njësinë bazë në fushën dentare.</p> <p>Per sa i përket tregut të punës ai do të shihet në përthithjen e katër profesionistëve dentarë për një periudhë të shkurtër kohore.</p> <p><i>Statuti i Kolegjit Universitar REALD.</i> <i>Strategjia e zhvillimit 2016 - 2021.</i></p>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Ndihmës Dentar” është hartuar në përputhje me aktet kryesore të IAL, konkretisht me statutin, rregulloren e përgjithshme dhe rregulloren e Fakultetit në të cilat janë parashikuar drejtimit prioritar akademike. Në këtë dokumentacion përcaktohet misioni i shkollës, struktura e brendshme me menyrën e funksionimit të saj, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, të personelit akademik dhe administrativ, të studentëve, të bashkëpunësorëve të IAL, rregullat për pranimin e studentëve, për rekrutimin e personelit akademik, për mesimdhëniën, për organizimin e praktikave të laboratorëve, për menyrën e vlerësimit, të diplomimit, të anagazhimit në aktivitete shkencore, për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, si dhe masat në rastin e shkeljes së rregullores.</p> <p>Per sa i përket rekrutimit të personelit akademik duhet të rritet numri i tyre me gradë dhe tituj shkencorë.</p> <p><i>Statuti i Kolegjit Universitar REALD.</i> <i>Rregullore e Përgjithshme.</i> <i>Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore - 2018.</i></p>
Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për	<p>Programi i studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqipëtare e Kualifikimit. Ky program studimi organizohet me kohë të plotë dhe zhvillohet nga një staf akademik me eksperiencë të mjaftueshme në fushën e mesimdhëniës dhe atë të mjekësisë, por me mungesë të gradave dhe të titujve sipas kriteve ligjore të parashikuara nga IAL. Ky program studimi është hartuar në</p>

Naxhi Koci
Arbaci

B.M.

programin e studimit.	perputhje me fushat dhe drejtimet akademike te IAL. <i>Stafi akademik i angazhuar ne procesin mesimor ne Ndhimes Dentar.</i>			
Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Nga shqyrtimi i DVV qe institucioni ka dorezuar per akreditimin e ketij programi studimi, vihet re qe institucioni ka realizuar nje studim tregu ne vitin 2018. Megjithate GVJ eshte e mendimit se nevojat e punes per keto profesioniste do te shikohen ne nje periudhe afatshkurter kur ata te kerkohen nga klinikat e ndryshme dentare, per te cilen do te shihet ne te ardhmen e afert. Per tregun nderkombetar GVJ mbetet skeptike. <i>Studim i tregut per nevojat per ndihmes dentar - Janar 2018.</i>			
Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimitin e studentëve.	Rezultoni se Institucioni ka bere nje studim te tregut te punes duke vleresuar nevojat e ketij tregu nga specialist te fushes perkatese dhe nga studimi ka rezultuar se ka nevojte per “Ndhimes Dentare”, por eshte akoma heret per te dhene nje mendim per perthitjen e ketyre profesionisteve “Ndhimes Dentar” nga tregu aktual i punes si dhe pa nenvleftesuar daljen e ketyre profesionisteve nga Institucionet e tjera te Arsimit te Larte publik apo privat ne Shqiperi. <i>(Evidenca 75)</i>			
Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimitin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Nga studimet paraprake dhe periodike te realizuara nga Institucioni ka rezultuar e vertete qe tregu i punes ka nevoja reale per keto profesioniste “Ndhimes dentare”, kjo e vertetuar dhe nga kriteret per klinikat dentare ne baze te numrit te poltronave. Por varet qe keto klinika do te kerkojne Infermiere, Ndhimes Dentare apo Higjeniste Dentare, te cilet ne vendin tone po pregatiten me nje numer te konsiderueshem per te dale ne tregun e Stomatologjise, e cila do te percaktohet ne prespektiven nga tregu i punes. Ketu nuk duhen neleftesuar nevojat specifike te qytetit turistik te Vlores qe i jep nje shtyese te madhe ketij program studimi. <i>(Evidenca 75)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së	I gjithë stafi i programit te studimit ka te percaktuar qarte detyrat dhe rolet, ne perputhje me objektivat dhe qellimet e programit te studimit, personeli akademik eshte i angazhuar ne mesimdhene sipas fushave te peraferta ku ato jane eksperte dhe specialiste. Ndarja e lendeve eshte bere ne baze te kualifikimit te tyre. Ngarkesa mesimore e sftafit behet ne baze te kualifikimit, te funksioneve qe ka pedagogu ne njesine baze apo ne IAL. Per sa i perket personelit ndihmes mesimore, ato duke gene

Naxmi Koci
Arso

[Signature]

vazhdueshme të punës së tyre.	pergjegjes te laboratoreve apo te klinikes dentare brenda struktures se IAL mundohen te sigurojne gjithë materialet e nevojshme si gjate procesit te mesimdhënies ashtu dhe gjate punes se pavarur te studenteve. <i>Rregullore e Programit Ndhimes Dentar - 2019. Te dhena per personelin akademik - per vitin akademik 2019 - 2020.</i>			
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.	IAL per realizimin e objektivave te procesit mesimor dhe formues te studentave ka nenshkruar marrveshje bashkepunimi me klinika te ndryshme dentare ne qytetin e Vlores per realizimin e programit, kurrikulave sidomos ate te praktikës mesimore. Per sa i perket bashkepunimit me IAL e huaja permendet Universiteti i Fogias Itali per te cilen ndoshta dhe per arsye te Covid 19 duhen rinovuar kontratat. <i>Marveshja me Uni Foggia - e firmosur.</i> <i>Marveshjet e bashkepunimit me institucionet homologe brenda dhe jashte vendit.</i>			
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Institucioni ka krijuar marreveshje bashkepunimi me Klinika Dentare Rajonale dhe nga vleresimi periodik i njesise pergjegjese ka rezultuar se studetet e ketij Institucion kane pasur perfitim shume te mire nga keto bashkepunime per sa i perket ciklit te Integruar ne Stomatologji , por duke qene se ne ciklin e integruar Ndhimes Dentar praktika do te jete ne semestrin e dyte eshte per tu vleresuar ne afatin kohor nese dhe ky cikël do te kete te njejtin perfitim nga bashkepunimet me klinikat si cikli i integruar ne Stomatologji . <i>(Evidenca 28) (Evidenca 31)</i>			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Mendojme qe marreveshjet e bashkepunimit me institucionet partnere te rinovohen dhe te nenshkruhen me kujdes ne baze te legjislacionit ne fuqi. Studentet kane nje pedagog pergjegjes qe u vlereson praktikat e tyre. Dhe ne varesi te programit ka mbikqyeres per cdo marrveshje bashkepunimi. <i>(Aneksi 31;32;33 Marreveshjet e bashkepunimit)</i>			
Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	Nga takimet e realizuara ne institucion GVJ konstaton se perpjekjet e IAL per punesimin e studeteve te diplomuar jane maksimale duke vene ne pune zyren e Keshillimit te Karrieres e cila siguron te dhena per nevojat e klinikave dentare rajonale te qytetit te Vlores dhe ndihmon per punesimin e ketyre profesionisteve. <i>(Evidenca 24)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi

Naxmi Koci
Arçis

[Signature]

<p>Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Kurrikulat e programit të studimit janë të ndertuara pjesërisht mbi bazen e sistemit European të Transferimit të Krediteve dhe në përputhje me statutin e IAL apo legjislacionin Shqipëtar në fuqi. Programi është i ndare në 2 vite akademike dhe në 4 semestre. Është i përbërë nga 21 lëndë/module dhe në total ka 120 ECTS, këto të ndara specifikisht sipas lendeve përkatëse.</p> <p><i>(Evidenca 13) (Evidenca 14)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithëpërfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p>	<p>Ky program studimi i pajis studentet me kompetencë në njohuritë e Etikës dhe Deontologjisë Profesionale, legjislacionit mjekësor si dhe ruajtjen e sekretit profesional. Ky program gjithashtu u ofron studentëve njohuri të mjaftueshme të shërbimit mjekësor, të higjenes spitalore, të trajtimit ambulator të pacientëve, njohjen me aparataturat mjekësore, mirëmbajtjen e tyre, përgatitjen e pacientëve para intervenimeve dentare si dhe ndjekjen në vazhdimësi të tyre. Gjithashtu studentet nëpërmjet këtij programi aftësohen lidhur me mënyrën e komunikimit midis kolegëve, eprorëve, vartësve, pacientëve, familjarëve të tyre, përdorimit të mjeteve informative midis personelit mjekësor dhe pacientit. <i>Plani Mësimor i programit - Ndihmës Dentar - 2 vjeçar.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>Ndihmes dentaret nëpërmjet këtij program studimi aftësohen si ndihmes në fushën e Stomatologjisë dhe të Shëndetit të pacientit. Këta profesionistë janë të aftë të ndihmojnë mjekun stomatolog në parandalimin, diagnozën si dhe mjekimin e pacientëve që kanë nevojë për kujdes dentar. Besueshmëria e këtyre profesionistëve do të shihet në një të ardhme të afërt duke anketuar mjekët stomatologë të klinikave të ndryshme. Gjithësesi programi i ofruar krijon mundësi reale në përgatitjen e tyre dhe përballimin e situatave konkrete në praktikën klinike. <i>(Evidenca 14)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndshueshme.</p>	<p>Mendojmë se nëpërmjet këtij program studimi “Ndihmes Dentaret” mund të behen pjesë integrale e klinikave dentare, sigurisht pa nënvlefësuar nivelin e përgatitjes së tyre dhe konkurrencën e lartë. Programi i studimit që ofron ky IAL siguron përgatitjen e nevojshme profesionale të kandidatëve për të menaxhuar situata konkrete të praktikës klinike si pjesë e stafit që do të merret me zgjidhjen e tyre. Ky nivel përgatitjeje u jep atyre mundësinë e mendimit të pavarur profesional e etik për vendosjen e diagnozës dhe mënyrën e trajtimit dhe realizimin konkret të tyre në praktike, çka shoqëruar me punën në ekip bën të mundur një mjekim cilësor. Në këto procedura mjekimi ndihmësi dentar ka rolin e tij dhe rrit cilësinë e mjekimit dhe rendimentin në punën e stafit diagnostikues e mjekues të pacientit. <i>(Evidenca 29) (Evidenca 49)</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>Per sa i perket struktures akademike te ketij program dhe shkalles se kualifikimit te stafit akademik ajo duhet permiresuar ne nje te ardhme sa me te afert.</p> <p>Sic parashikohet nga ligji per arsimin e larte 80/2015 struktura e departamentit ka nevojte te permiresohet dhe sigurohet numri i nevojshem i specialisteve te fushes te cilet ne rastin konkret eshte mire tu pergjigjen edhe nenspecialiteteve e qe ka kurikula e programit te studimit.</p> <p>Departamenti i Stomatologjise per vitin akademik 2018-2019 përbëhej nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 17 personel akademik efektiv (PAE): 1 Prof.Dr, 4 Dr. dhe 12 Msc. - 1 personel akademik me kontratë (PAK): 1 Dr. <p>Ndërkohë, Departamenti i Stomatologjise për vitin akademik 2019-2020 përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 7 personel akademik efektiv (PAE): 3 Dr. dhe 4 Msc. - 2 personel akademik me kontratë (PAK): 2 Msc. <p>Personeli akademik përmbush kriteret ligjore për për titull e grade, për të qenë pjesë e njësisë bazë. <i>(Aneksi 61 dhe aneksi 62 i dok shoqeruese te RVB)</i></p>
---	--

<p>Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Ky program ka objektiva te percaktuara qarte per formimin e nje profili profesional te mjaftueshem por duhet te perpiqet qe keto objektiva te realizohen plotesisht ne praktike. Keto jane te percaktuara qarte ne rregulloren perkatese te programit te studimit dhe ne kurikulat perkatese te cdo lende qe zhvillohet. Keto i pajisin studentete me dije te mjaftueshme e bashkekohore ne fushen e ofruar te studimit, por dhe me kompetencat e nevojshme profesionale te nevojshme per aktivitetin praktike qe ata do te kryejene me pacientet.</p> <p><i>(Aneksi 9-Rregullore e programit te studimit)</i></p>
---	---

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Naxmi Koci
Arçis



II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.	Ky program studimi është i bazuar ne kerkesat e ligjit 80/2015 “Per arsimin e larte dhe kerkimin shkencor ne R.SH.” dhe aktet nenligjore qe burojne prej tij. Per hapjen e programit te studimit te ciklit te pare te arsimit te larte “Ndhimes Dentar” është ndjekur nje procedure e rregullt ligjore institucionale e cila është permyllur me kerkesen e IAL per MASR me nr. 64, date 17.04.2020 dhe qe është shoqeruar me dosjen perkatese. Ky dokumentacion nga ana e ASCAL-it dhe nga ana jone si eksperte u gjet i plote dhe sipas kerkesave te formatit te ketij programi studimi. Ai permban informacionin e duhur lidhur me objektivat formuese te programit, menyren e organizimit, strukturen, permbajtjen e tij dhe rezultatet e pritshme gjate realizimit perfundimtar te programit. Jane te qarta ne dokumentacion dhe nga ana e studenteve qe po vijojne kete program fushat e punesimit dhe mundesite reale te tij. Eshte pozitiv fakti se nje pjese e konsiderueshme e kontigentit te studenteve qe vazhdojne studimet ne kete program, qe ne momentin e kryerjes se praktikave mesimore ne institucione private ku kane punuar sipas kontratave qe ka Institucioni me to, kane arritur te sigurojne nje vend pune dhe jane ne pritje te marrjes se Diplomes, per te lidhur nje kontrate definitive pune dhe per te vijuar normalisht profesionin ne te cilin jane pergatitur. <i>(Evidenca 14)</i>
Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.	Programi i studimit “Ndhimes Dentar” qe ka organizuar IAL Kolegji Universitar REALD ne Vlore, jane te organizuara sipas kerkesave Te Kartes se Bolonjes. Ato jane te ndara ne module e lende dhe kane aktivitete formuese te larmishme per te pergatitur ne nivelin e duhur kandidatet qe vijojne studimet. Programet jane te organizuara ne ore mesimore ditore, javore e mujore, qe realizohen ne auditore dhe jashte tyre ne praktika profesionale ne Institucion dhe neper klinika e kabinete private dhe jane te vleresuara ne kredite ECTS. Programi është i ndare ne vite e semestra sipas kerkesave te Kornizes Shqiptare te Kualifikimeve dhe i korespondon Niveli 5 te saj. Programi i ofruar nga ky institucion, është gjithashtu ne perputhje me kerkesat e KEK dhe krijon mundesine e njohjes dhe te transferimit te krediteve. Ky program studimi permban 120 kredite dhe realizohet ne 2 vite akademike me kohe te plote dhe duke realizuar respektivisht nga 60 kredite secili. Te gjitha keto jane te pasquruara ne Planin mesimor te ketij programi. <i>(Aneksi 15- Plani mesimor i programit Ndhimes Dentar)</i>
Kriteri 3. Programet e studimit	Programet e studimit qe ofrohet kane nje plan mesimor te detajuar ku

Naxmi Koci
Arso

B

<p>përbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>perفشihen te gjithë informacionet e nevojshme rreth tij. Jane te detajuara ngarkesa mesimore e programit si dhe menyra e organizimit te tij, oret mesimore qe do te zhvillohen ne auditor, leksionet e seminaret dhe punet ne laboratore si ai i fantomes ku studentet marrin njohurite e duhura dhe pergatiten ne menyre didaktike per te kaluar ne praktikat profesionale e punen me paciente. Jane te percaktuara edhe detyrat per frekuentimin si dhe rendesia e ketyre procedurave ne vleresimin e perditshem dhe ate perfundimtar te njohurive. Ne program ka te percaktuara edhe detyra specifike me karakter formues e profesional qe cojne ne pergatitjen graduale e te qendrueshme te studenteve qe vazhdojne kete program studimi. <i>(Aneksi 15- Plani mesimor i programit Ndhimes Dentar), (Aneksi 16- Programi mesimor Ndhimes Dentar)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikën, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit i ka te hartuara qarte syllabuset e te gjitha lendeve qe zhvillohen gjate tij. Syllabuset shoqerohen jo vetem me tematiken e plote te problemeve qe trajtohen ne kete program, por edhe me literature perkatese te ndare ne ate kryesore dhe ate shoqeruese. Per rastet kur literature baze, per vete vecorite e programit nuk eshte e plote, ajo eshte shoqeruar me leksione te shtypura te hartuara nga pedogoget e lendeve te cilet ruhen ne sekretarine e Institucionit dhe u ofrohen studenteve pa pagese. Ne kerkuam te shohim kopje te tyre dhe na u vune ne dispozicin pa pengese. Programi i studimit eshte i detajuar per cdo lende dhe i ndare specifikisht ne leksione, ushtrime, pune laboratorike dhe te gjithë komponentet e tjere qe jane parashikuar te zhvillohen gjate tij. Raporti i oreve mesimore ne auditor me ato qe do te zhvillohen jashte tij dhe puna e pavarur e studenteve ka mundesi te harmonizohet me tej gje qe mund te behet brenda hapësirave qe jep ligji per mundesine e riororganizimit deri ne masen 20% nga vete Institucioni, duke vene ne dijeni MASR dhe kjo u la si detyre qe te realizohet ne te ardhmen. Ne programin e studimit jane te parashikuar edhe marreveshjet bashkepunuese me institucione te tjera ku do te zhvillohen praktikat e studenteve. Dokumentacioni lidhur me strukturen e vitit akademik, kalendarin e provimeve, stafin akademik mesimdhene e ate ndihmes, u gjet sic eshte raportuar ne dokumentacinin qe shoqeron kerkesen. <i>(Aneksi 15- Plani mesimor i programit Ndhimes Dentar), (Aneksi 16- Programi mesimor Ndhimes Dentar), (Aneksi 31,32,33- Marreveshjet e bashkepunimit)</i></p>
<p>Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmerisht fleksibel për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Permbajtja e ketij programi studimi eshte mjaftueshmerisht fleksibel dhe i sherben realizimit te qellimit per te cilin ai eshte hapur. Programi e lejon mundesine e vazhdimet te metejshem te studimeve apo ate te transferimit ne nje program tjetër permes sistemit te krediteve. Keto jane te percaktuara qartesisht ne rregulloren e programit te studimeve. Perfundimi me sukses i ketij programi ben te mundur formimin e tyre ne pershtatje me profilin e ofruar dhe kerkesat qe ka ky titull studimi qe realizohet ne perfundim te tij. Plani mesimor eshte realizuar duke patur nje ndarje qe perkon me kerkesat nenligjore per kete problem. Ai eshte i ndare ne: Disiplina te formimit baze, disiplina te formimit karakterizues, lende nderdisiplinore dhe</p>

Naxmi Koci
Arso

	<p>integruese lende me zgjedhje, disiplina plotesuese dhe veprimtari permbyllese qe realizojne perfundimisht diplomimin e studenteve. Lidhur ndarjen e lendeve te detyrueshme dhe atyre me zgjedhje, pasi u degjuan edhe studentet, pa cenuar autonomine e institucionit, u bene disa rekomandime si psh. Vendosja e kirurgjise stomatologjike si lende e detyrueshme dhe kalimi i lendes se shkrimit akademik ne lende me zgjedhje. Gjithashtu u sugjerua edhe lidhur me sasine dhe shperndarjen e oreve te punes se pavarur te studenteve dhe te praktikave profesionale. Te gjitha keto jane te mundeshme te realizohen nga ana e IAL ne kuader te kuotes prej 20 % te mundesise se ndryshimeve qe u jep ligji, pa e cenuar teresine e programit i cili pergjithesisht rezulton i sukseshem dhe i kerkuar. Kjo ben qe ky program te shtoje ne kurikulen e tij edhe disa njohuri ne fushen e asistences ne stomatologji. Kjo per faktin se tregu i ketij sherbimi ka inflacion ne pergatitjen e stomatologeve dhe ka disa mungesa ne fushen e asistences dentare. <i>(Evidenca13)</i></p>			
<p>Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>Mesimi praktik ne kete program studimi eshte vleresuar realisht. Ai zhvillohet ne disa menyra per te cilat jane mare masat e duhura dhe eshte krijuar infrastruktura e nevojshme. Ne kabinetin e fantomes ku mund te zhvillohen praktika paraklinike, jane organizuar 10 poste me manikine dhe gjithe paisjet e tjera qe nevojiten per nje praktike normale dhe ku teorikisht mund te praktikohen deri 20 studente njekohesisht. Duke qene se, grupet e vogla ne praktike perbehen nga deri 10 studente, ky mjedis eshte me se i mjaftueshem. Nderkohe edhe praktikat klinike mund te zhvillohen ne kushte plotesisht optimale brenda institucionit, pasi aty jane sjelle 7 unite dentare te reja dhe qe jane vendosur ne nje ambjent te ri e te bollshem dhe qe po montoheshin gjate kohes kur ne kryem viziten ne institucion. Pervec kesaj IAL ka lidhur marreveshje bashkepunimi me disa institucione te sherbimit dentar privat ne Vlore dhe qe jane te gatshem te presin studente ne kontigjente me te medha se sa numri i atyre qe frekuentojne aktualisht. Megjithate vrejttet tona lidhur me praktikat e studenteve qe u konsumuan direkt ne vend kane te bejne me shtimin e oreve te praktikës dhe nje balancim midis tyre dhe oreve te punes individuale qe ne ndonje rast jane perdorur thjesht per te rregulluar strukturen e programit. Aktualisht jane planifikuar 16 kredite ECTS per praktikat profesionale, por brenda hapësirave qe lejon ligji kjo shifer ka mundesi te permiresohet dhe praktika te zere vendin qe i takon ne kete program.<i>(Aneksi 33- Marreveshje bashkepunimi- Ndihmes Dentar)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi II.2
Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënimit sipas Kuadrit

Naxmi Koci
Arbaci



Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Emertimi i programit të studimit është në përputhje me kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore për programe të tilla me karakter profesional. Duke qenë se në praktiken e përditshme detyrat që do të kryejë kjo kategori specialistesh nderthuren me ato të asistentit dentar ai është emërtuar në këtë mënyrë. Meqë kur kjo kategori mbulonte shërbimin dhe punonin direkt në gojen e pacientit, janë quajtur N/Dentist. Kjo periudhë i përket viteve 1944- 1964 kur në vendin tonë nuk kishte mjekë stomatologë dhe dentist i mesëm ishte figura qendrore e shërbimit. Në kushtet aktuale, emërtimi duhet konsideruar si i drejtë. Shpërndarja e programit në vite e semestra është bërë në mënyrë të arsyeshme duke ruajtur parimet didaktike të të mesuarit si dhe ngarkesën përgjithësisht uniforme në javë mësimore, semestra e sipas viteve akademike. Programi është i organizuar në lende e module dhe i vlerësuar në kredite ECTS sipas kuadrit të Kornizës shqiptare dhe asaj Europiane të Kualifikimeve.</p> <p>Në program është patur parasysh dhe organizimi i tij sipas rëndësise së disiplinave të vecanta dhe rëndësise që ato zënë në këtë program studimi. Në të ka një ndarje të tillë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Lendet e formimit baze kanë 19 ECTS dhe përbejnë 15,8% - Lende të formimit karakterizues, 65 ECTS, 54,2% - Lende ndërdisiplinore /integruese 15 ECTS, 12,5% - Lende plotësuese me 16 ECTS, 13,3% - Detyrime përmblyese me 5 kredite ECTS, 4,2%. <p>Në këtë program studimi ka hapësira për të bërë përmirësim në strukturën e tij duke ju dhënë përparësi disa disiplinave të profilit dhe punës në praktikën klinike gjë që mund të realizohet sipas kërkesave të ligjit, pa e cenuar programin në teresi, por duke e përmirësuar me tej atë. <i>(Aneksi 16- Programi mësimor Ndihmes Dentar), (Aneksi 15- Plani mësimor Ndihmes Dentar)</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënësve dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi i programit të studimit dhe mënyra e organizimit të tij, shpërndarja e lendeve në vite e semestra dhe vlerësimi në kredite e orë mësimore që është realizuar, mundësojnë plotësimin e objektivave të programit. Kjo bën të mundur realizimin e objektivave formues të programit si nga ana teorike, ashtu edhe në rrafshin praktik. Kjo mënyrë organizimi mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të këtij programi në fushën e të nxënësve teorik të dijeve dhe në përvetësimin e shprehive profesionale praktike që e bëjnë studentin të aftë për të përballuar çdo situatë të mundshme gjatë ushtrimit të profesionit në shërbim të pacientëve. Formimi teorik i kandidatëve dhe përvetësimi i njohurive praktike të nevojshme krijon premisat për një punësim të shpejtë të tyre si dhe përballimin me sukses të kërkesave të tregut të punës nga ana e tyre. <i>(Evidenca 14)</i></p>

<p>Kriteri 3. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>Plani mesimor i ketij programi është hartuar në mënyrë të detajuar e të qartë. Emërtimi i lëndëve dhe i moduleve është i drejtë dhe i korespondon si nevojës për informacion bashkëkohor, ashtu edhe terminologjisë së duhur mjekësore dhe shpreh përmbajtjen sintetike të lëndës apo të modulit të dhënë. Syllabuset e moduleve e të lëndëve janë të hartuara qartë e në mënyrë të detajuar, janë informuese dhe përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm. Në to është përcaktuar numri i orëve dhe krediteve që realizohen në syllabusin përkatës, koha kur zhvillohet lenda, përmbajtja thelbësore e saj, mënyra e zhvillimit të asaj lende si dhe literatura bazë dhe ajo ndihmëse që duhet shfrytëzuar gjatë zhvillimit të saj. Janë të përcaktuara gjithashtu edhe orët që do të zhvillohen në auditor, që janë të ndara në leksione, seminare, orët në laborator dhe orët jashtë auditorit. Janë të parashikuara në mënyrë të qartë edhe orët e praktikave profesionale që do të kryhen gjatë programit të cilat realizojnë 16 kredite (ECST). Për të gjitha këto ka informacion të shkruar që ndodhet në dosjen përkatëse që ka paraqitur institucioni. Ky informacion mund të merret edhe në rrugë elektronike në adresën e IAL ëëë.unireald.edu.al. I hartuar në këtë mënyrë Plani mesimor garanton përfitimin e dijeve, aftësive të nevojshme dhe të shprehive praktike të kandidatit për të qenë i qartë teorikisht dhe i aftë profesionalisht për ushtrimin e profesionit në shërbim ndaj njerezve. (Aneksi 15- Plani mesimor Ndihmes Dentar) (Aneksi 21,22,23,24- syllabuset Ndihmes Dentar)</p>
<p>Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundërt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>Ky program ka një raport të caktuar midis moduleve, lëndëve dhe aktiviteteve të formimit teorik me ato të përgatitjes praktike të studenteve. Ka nevojë për një rregullim në raportin midis tyre për një harmonizim me të plotë për të cilin hartuesit ran dakord gjatë vizites në institucion dhe moren përsipër që ta rregullojnë atë në mënyrë të shpejtë duke shfrytëzuar hapsirën që u krijon ligji duke ju dhënë të drejtën e ndryshimit të programit deri në masën 20% dhe venien në dijeni të MASR. Duhet përmirësuar raporti teori / praktike pasi në varjantin e paraqitur numri i orëve praktike nuk arrin deri në 50% në raport me ato të formimit teorik. Mundësitë e korigjimit janë të mundura brenda hapsirave që lejon ligji. Raporti 25 orë mësimore për 1 kredit ECTS është i realizuar. Praktika profesionale në shërbim të pacientëve arrin në masën 25% të programit duke marrë parasysh se përveç praktikës klinike I dhe II që janë module me vehte, studentët bëjnë praktike laboratorike gjatë gjithë vitit akademik në lëndet karakterizuese të programit të studimit. (Evidenca 14)</p>
<p>Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e</p>	<p>Aktivitetet formuese gjatë ketij programi janë të larmishme dhe bëjnë kombinimin e njohurive teorike me ato praktike në raporte të pranueshme sipas kërkesave të ligjit dhe të akteve nenligjore për këto probleme. Kjo bën të mundur realizimin e objektivave të programit të studimit dhe aftësimin e tyre për të ushtruar me kompetencë profesionin që fitohet pas përfundimit të ketij programi studimi. Mënyra e organizimit të programit e bën të mundur orientimin e studentëve drejt studimeve të mëtejshme duke qenë se njohuritë e marra gjatë ketij programi janë të matshme dhe</p>

Naxmi Koci
Arçis

kërkesat e tregut e punës.	te vleresuara ne kredite ECST. Programi i zhvilluar nga IAL REALD pas realizimit te tij ploteson objektivat e pritshme te formimit teorik dhe te shprehive praktike te nevojshme sipas kerkesave te tregut te punes i cili eshte i hapur dhe krijon mundesine e punesimit te shpejte te tyre. Duke marre parasysh se ne vendin tone ka disa IAL qe realizojne studime te integruara te ciklit te dyte ne stomatologji, numri i tyre ne vendin tone eshte relativisht i larte, programi ne fjale ploteson nje pjese te mozaikut te sherbimit stomatologjik per te cilin ka mungese relative, ndaj dhe kjo e ben te mundur qe ata qe kryejne kete program studimi te jene te mirepritur ne tregun e punes te sherbimit stomatologjik shqiptar.(<i>Aneksi 16- Programi mesimor Ndihmes Dentar</i>), (<i>Aneksi 15- Plani mesimor Ndihmes Dentar</i>)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.3	
Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.	Programi i studimit qe analizohet permban te dhena te plota mbi permbajtjen e lendeve dhe te moduleve qe zhvillohen gjate tij. Ne te zene vendin e duhur lendet teorike baze te formimit te pergjithshem e mjekesor. Ato kane renditjen e duhur dhe ngarkesen e nevojshme qe i pergjigjet ketij programi i studimi. Lendet e formimit karakterizues jane gjithashtu te renditura drejt sipas parimeve te duhura didaktike dhe kane permbajtje te qarte e japin vellimin e duhur te njohurive per nivelin e ketij programi. IAL, ju la detyre qe te beje disa ndryshime midis lendeve te karakterit detyrues qe ka ne program, me lende qe jane parashikuar me zgjedhje. Ky ndryshim i rekomanduar rrit peshen specifike te lendeve te specialitetit ne program dhe mund te realizohet sipas kerkesave te ligjit pa cenuar permbajtjen teresore te programit. Praktikisht lenda e kirurgjise stomatologjike qe eshte lende specialiteti dhe jep informacion mbi ndihmen ne kushtet e urgjences mjeksore ne kete sherbim u rekomandua qe te jete lende me karakter detyrues. Edhe lendet dhe aktivitetet e formimit praktik te studenteve jane parashikuar pergjithesisht ne menyre te drejte e sipas struktures se planit te studimit. Nga ana jone u sugjerua qe nga vellimi i pergjithshem i oreve mesimore, te behen disa modifikime qe i japin perparesi punes klinike direkt me pacientin. Kjo, jo vetem per te krijuar raporte me te drejta midis disiplinave qe zhvillohen, por kryesisht per te rritur aftesite e tyre per menaxhimin praktik te rasteve gjate mjekimit apo gjate asistences mjekesore ne stomatologji.

Naxmi Koci
Arbore

	<i>(Evidenca 25) (Evidenca 4) (Evidenca 47) (Evidenca 14)</i>
Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.	<p>Permbajtja e programit të studimit ka informacionin e nevojshëm dhe jep dije bashkohore. Kjo u vret gjatë analizës së vëmendshme të syllabuseve e të lendeve që zhvillohen gjatë tij. Informacioni është aktual dhe me përmbajtje të qarta shkencore. Ai i plotëson kërkesat e profesionit në mënyrë të mjaftueshme dhe u jep mundësi kandidatëve që të punojnë në ekip për të realizuar një shërbim cilësor mjekësor. Ai u krijon atyre mundësi që për procedurë të veçanta të jenë të aftë të menaxhojnë të pavarur raste klinike e sidomos të japin ndihmën e parë të karakterit stomatologjik në fushën e asistencës stomatologjike dhe të ruajtjes së higjenes e të kujdesit të shëndetit të gojës. Për këtë vlen edhe përvoja e dikurshme, pasi në vitet 1948 deri në vitin 1964, kjo kategori specialistesh (e emërtuar Ndihmes Dentist) ka qenë figura qendrore, po thuajse e vetme, e shërbimit stomatologjik shqiptar. Niveli i njohurive që fitohen gjatë këtij programi dhe aftësitë e tyre praktike janë të tilla që u përgjigjen kërkesave të punëdhënësve. Këtu e vërteton edhe fakti që një pjesë e konsiderueshme e tyre janë ftuar për të punuar në disa klinika dentare të shërbimit stomatologjik privat dhe presin momentin e diplomimit që të punësohen në mënyrë perfundimtare. Një kontingjent tjetër i atyre që ndjekin këtë program studimi, kanë të afërm ose familjare të tyre që punojnë në këtë sektor dhe janë ftuar para kohe të aktivizohen në punë ku sterviten dhe punojnë njëkohësisht. <i>(Evidenca 14)</i></p>
Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjes së tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.	<p>Permbajtja e programit, parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme teorike e profesionale të studentëve. Kjo është e parashikuar në modulet dhe lëndet që zhvillohen gjatë realizimit të programit. Në përmbajtjen e kurrikulës është e tillë me informacion të bollshëm e fleksibel, për përmirësimin e të cilit është marrë edhe mendimi i studentëve të vitit të fundit dhe atyre që kanë përfunduar studimet në këtë program. Kjo u konstatua edhe nga ana jone në konsultën me studentet dhe një bashkëbisedim të kujdeshëm që patëm mundësi të zhvillonim direkt me ta, pa praninë e stafit akademik, gjatë të cilit u siguroi diskutim i lirë dhe pati mendime të vlefshme. Këtë qëllim i kanë shërbyer edhe metodat e mësimdhënies, të cilat janë të larmishme dhe dinamike duke u fokusuar në rëndësi dhe përmbajtjen praktike të manipulimeve teknike dhe krijimit të shprehive teorike dhe manuale të qarta e të qëndrueshme. U konstatua se edhe metodat e vlerësimit të dijeve të studentëve kanë dinamike, të larmishme dhe të përditshme. Janë gjetur mekanizmat e duhura për të stimuluar si pjesëmarrjen e vazhdueshme të studentëve gjatë realizimit të veprimtarive mësimore teorike e ato të karakterit praktik, ashtu edhe aktivizimin e përditshëm të tyre në diskutimet teorike dhe manipulimet praktike dhe vlerësimin periodik e të vazhdueshëm të njohurive nga ana e tyre. <i>(Evidenca 14)</i></p>
Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përfundimin e njohurive, aftësive dhe	<p>Modulet dhe lëndet që zhvillohen gjatë këtij programi mundësojnë përfundimin e njohurive baze mjekësore në fushën e shëndetit oral. Ato shërbejnë jo vetëm për të krijuar shtratin e nevojshëm teorik të njohurive</p>

Naxhi Koci
Arbaci

BM

<p>shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.</p>	<p>baze që kërkon ky specialitet, por edhe për të dhënë shprehite e duhura të manipulimeve praktike që janë shumë të nevojshme në këto specialitete. Studentët gjatë realizimit të programit janë aktivizuar e kontrolluar periodikisht e në mënyrë të vazhduar duke nxitur të menduarit kritik e praktik të tyre. Për këto kanë shërbyer situata reale të paraqitura gjatë punës me pacientë, por edhe situatat hipotetike të krijuar nga pedagogët me përvojë sidomos gjatë veprimtarive praktike apo në seminarët e zhvilluara. Në analizën dhe zgjidhjen konkrete të problemeve teknike është aktivizuar shpesh i gjithë grupi i studentëve dhe nën drejtimin e pedagogut apo tutorit, është arritur në një përfundim konkret dhe zgjidhjen reale e të drejtë të rastit. Kjo ka krijuar shprehite e nevojshme tek studentët e këtij programi. Programi i studimit i krijuar hapësirë e nevojshme edhe për një problem tjetër shumë të nevojshëm, që është puna në ekip, raportet dhe komunikimi me pacientët dhe kolegët. Për këto ka një modul të posaçëm që bën fjalë për etikën dhe deontologjinë mjekësore. E gjitha kjo është pjesë e formimit profesional të programit dhe vjen si detyrë e dorës së parë në formimin e këtyre specialistëve, krahas atij profesional, teorik e manual të tyre. <i>(Evidenca 43)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Programi e ka të percaktuar përmes njohurive që jep, protokolleve dhe rregulloreve të tij sigurimin e bashkëpunimit me aktorët që marrin pjesë në realizimin e programit dhe punëdhënësit. Gjatë kryerjes së praktikave profesionale në institucionet e shërbimit privat me të cilat institucioni ka marrëveshje të shkruara qarta dhe me objektiva konkrete jepen vlerësime edhe nga ana e punëdhënësve, të cilat merren në konsideratë në vlerësimin përfundimtar të studentëve. Për këto ka praktika të qarta e të shkruara. Po kështu, gjatë praktikave në Institucion dhe gjatë tij, studentët monitorohen nga tutorë që zgjedh IAL apo institucioni që kryen praktiken. Ky lloj monitorimi dhe kontrolli, i kryer çdo ditë e për çdo gjë krijon një proces kontrolli të vazhdueshëm që nxit dhe aftëson studentët në formimin praktik të tyre.</p> <p>Praktikat profesionale zhvillohen në institucione sipas profilit që ata kanë dhe nën drejtimin e pedagogut të ngarkuar nga Departamenti i stomatologjisë. Vec detyrave që ka, programi i studimeve, kandidatët në këto rast janë të detyruar të respektojnë edhe rregullat e Institucionit ku zhvillohet praktika. Analizat periodike që ka zhvilluar njesia baze lidhur me këto probleme kanë bërë vlerësimin e efikasitetit të bashkëpunimit me institucionet partnere për zhvillimin e praktikave mesimore. Në fund të vitit akademik njesia baze ka hartuar edhe një raport analitik për përfitimet e nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programit të studimit. Në përfundim është konkluduar se përfitimet nga këto forma bashkëpunimi kanë qenë reciproke. <i>(Aneksi 31,32,33- Marrëveshjet e bashkëpunimit- Ndihmes Dentar)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Naxmi Koci
Arso

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Naxmi Koci
Arboret



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>KU “REALD” ka hartuar udhëzues të posaçem dhe ka ngritur struktura mesimdhënese dhe monitoruese të posaçme me të cilat ndiqet në vazhdimësi dhe kontrollohet niveli i mesimdhënies dhe i njohurive të marra në institucion. Mekanizmat e vlerësimit dhe të kontrollit periodik të cilësisë në institucion veprojnë sipas rregulloreve perkatese dhe sidomos të asaj të programit të studimit. Për këtë qëllim është krijuar enkas si struktura e vecante për kontrollin e cilësisë NJSBC e cila ka funksionuar periodikisht e në vazhdimësi sipas kërkesave të rregullores perkatese. Ky instrument monitorues ka verifikuar në vazhdimësi procesin e mesimdhënies, aftësitë mesimdhënese të personelit akademik dhe ndihmes akademik dhe cilësinë e rezultatet e mesimdhënies. Nepermjet pyetesoreve dhe anketave të zhvilluara sipas rastit, por jo më pak se dy herë në vit, janë marrë në mënyrë direkte e të pa censuruara përshtypjet e studenteve për metodat e mesimdhënies dhe aftësitë e mesimdhëneseve, por dhe për organizimin e procesit mesimor pedagogjik apo praktikave profesionale si dhe për kushtet e krijuara për mesimdhënie. Të gjitha këto, të përfituara në mënyrë anonime, janë përpunuar dhe rezultatet e tyre janë prezantuar në njësinë baze të mesimdhënies. NJSBC për këtë qëllim ka hartuar raporte të vecanta sidomos ato semestrale dhe vjetore.</p> <p>Po kështu, Departamenti si njësi baze ka monitoruar periodikisht nivelin e mesimdhënies në çdo lende e të çdo pedagogu të vecante duke bërë kontrole në leksione, seminare dhe gjatë praktikave profesionale brenda dhe jashtë institucionit.</p> <p>Të dhënat e grumbulluara gjatë këtyre kontrolleve janë pasqyruar në raportet vjetor të NJSBC dhe ruhen në Institucionin e u aksesuan gjatë vizites që u krye atje. <i>(Aneksi 39,40- formular të Njsbc)</i> <i>(Aneksi 6- Plani pune i Njsbc)</i></p>
<p>Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Format e mesimdhënies e të mesimnxënies janë të larmishme, tradicionale dhe novatore. Në këtë program studimi zënë vendin e tyre forma të tilla si leksionet, seminarët dhe punët laboratorike. Ato janë planëzuar qartë në planin mesimor të këtij programi dhe janë ndjekur në mënyrë korrekte nga strukturat perkatese të institucionit ku në qendër është njësia baze e zhvillimit të programit. Rëndësi të posaçme në larminë e këtyre metodave zënë edhe praktikat profesionale të studenteve që kryhen brenda institucionit dhe ku studentet ushtrohen mbi manekine profesionale dhe për këtë qëllim janë në dispozicion të studenteve 7 poste të tilla për praktika. Në të mund të ushtrohen me lehtësi deri në 14 studente, pasi nëse disa bëjnë detyrën e kuruesit kryesor, të tjerët bëjnë</p>

Naxmi Koci
Arçis

BM

	<p>ate te asistentit, gje qe eshte shume e rendesishme per kete program, pasi ai synon te jape njohuri pikerisht ne fushen e ndihmesit dhe te asistentit dentar. Megjithate grupet e vogla gjate kryerjes se praktikave profesionale jane deri ne 10 persona, kjo referuar edhe numrit te studenteve te regjistruar ne kete program. Edhe praktikat profesionale jashte institucionit zhvillohen ne kushte reale te praktikës se perditeshme dhe monitorohen nga drejtuesit e praktikës private dhe tutorët e ngarkuar per kete qellim Mendimi studenteve lidhur me ecurine e ketij procesi eshte marre ne menyre sistematike permes pyetesoreve qe jane kryer ne menyre anonime dhe rezultatet e te cileve jane perpunuar e nxjerre e detyra ne vazhdimesi per te ardhmen. Jane zhvilluar edhe detyra kursi dhe leksione te hapura sidomos me specialiste tane me experience dhe lektore te huaj me te cilet bashkepunon ky institucion.</p> <p>NJSBC qe eshte ngritur enkas ne funksion te ketij procesi ka funksionuar rregullisht. Te gjitha keto e kane bere procesin mesimor te larmishem dhe me rezultate qe sigurojne objektivat e percaktuara ne fillim te programit te studimeve. Kjo u pa ne vend dhe vleresohej si nje praktike pozitive edhe nga ana e vete studenteve sidomos te atyre te vitit te dyte apo qe i kishin kryer studimet me te cilet patem rastin te kontaktojmë direkt dhe pa pranine e stafit akademik. <i>(Aneksi 39,40- formular te NjsBC) (Aneksi 6- Plani pune i NjsBC)</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Personeli akademik mesimdhënes ne kete institucion ka perdorur metoda, forma e menyra mesimdhënieje te larmishme dhe alternative. Keto jane gjetur sipas lendeve e moduleve dhe kane simuluar situata konkrete qe i korespondojne kurikules se studimit dhe temave te vecanta. Larmia e rasteve praktike dhe pervoja klinike e stafit akademik e kane bere te mundur krijimin e situatave problemore ne zgjidhjen e te cilave jane perfshire te gjithe sidomos studentet. Keto jane pare me perparesi si metoda efektive mesimdhënieje dhe kane prioritet edhe mbi leksione akademike e me permbajtje te thelle shkencore pasi degjohen dhe pervesohen me lehtesi. Nje gje e tille dhe kryerja e aktiviteteve formuese ne kete program studimi kane perparesi per vete vecorite qe ai ka dhe karakterin teknik e professional te tij. Jane te percaktuar metodat qe do te perdoren ne lende e module te vecante nga ana e pedagoqeve qe ne hartimin e syllabuseve e kjo larmi formash e metodash ndryshon sipas disiplinave te vecanta te programit. Ne syllabuse eshte percaktuar qarte edhe literature qe do te perdoret per realizimin e lendes a modulit perkates, ajo kryesore apo ndihmese, ne gjuhen tone apo ne gjuhe te huaj.</p> <p>Ka te hartuara edhe protokolle mjekimi apo udhezues ne funksion te plotesimit te objektiveve te programit. Duhet te theksojme se u gjet me nivel mjaft te mire nje udhezues i hartuar me kriterë shkencore per hartimin e punimit te Diplomes. Ky ishte ne dispozicion te programeve te tjera te studimit, eshte i perdorshem edhe per kete program studimi duke e lene te hapur mundesine e atyre qe kane dëshire qe detyrimet permbyllesë te programit ti kryejne duke pergatitur Teme Diplome. Ky</p>

	<p>material paraqet vlera edhe per ata qe duan te hartojne nje shkrim me permbajtje shkencore. IAL eshte i pergatitur dhe ka aplikuar mesimin on line ne distance per lendet teorike te programit nepermjet platforms Google classroom. Disponohen per kete qellim tre manuale; manual per programin OBS, per regjistrim video dhe audio, ka manual per studentin dhe manual per pedagogun. <i>(Aneksi 21,22,23,24- Syllabuset e programit Ndhimes Dentar, (Aneksi 26- Stafit akademik i angazhuar ne progrmamin e studimit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i perfshire ne realizimin e ketij programi eshte i afte ne mesimdhenie dhe ka aftesit e nevojshme profesionale per realizimin e objektivave te ketij programi. Pervoja ne mesimdhenje dhe ajo ne praktiken profesionale klinike jane te mjaftueshme per kete program studimi. Per personelin akademik qe eshte angazhuar ne dhenien e lendeve te formimit karakterizues te ketij programi, kriteri i formimit shkencor te tyre plotesohet ne menyre te pjeseshme. Duke qene nje program studimi i ciklit te pare dhe me karakter profesional IAL ka bere kete gjetje per shkak te disa mungesave te specialisteve me tituj e grada shkencore. Aktivizimi i disa specialisteve me pervoje te gjate klinike dhe qe kane kryer studime ne programet SPA, ka krijuar disa lehtesi por nuk e zgjidh plotesisht problemin sipas kerkesave ligjore ne kete drejtim. Niveli profesional i stafit akademik pasqyrohet ne CV e tyre ku evidentohet pervoja e gjate klinike dhe pjesemarrja ne aktivitete shkencore e kualifikueses brenda e jashte vendit.</p> <p>Në këtë program studimi janë angazhuar për vitin akademik 2018-2019 vetem stafi akademik PAE si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 personel akademik efektiv (PAE): 3 Prof, 2 Dr, 5 Msc. <p>Ngarkesa totale mesimore eshte 100% PAE</p> <p>Ndërkohë në këtë program studimi janë angazhuar për vitin akademik 2019-2020 stafi akademik si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 13 personel akademik efektiv (PAE): 3 Prof, 2 Dr, 8 Msc. - 1 personel akademik me kontratë (PAK): 1 Msc. <p>Ngarkesa totale mesimore eshte 96% PAE dhe 4% PAK</p> <p>Personeli akademik plotëson kriteret ligjore për titull e gradë, për mësimdhënie në këtë program studimi. <i>(Aneksi 3-dok te kerkuara gjate vizites), (Aneksi 21-37- Syllabuset e programit Ndhimes Dentar), (Aneksi 38- Stafit akademik i angazhuar ne progrmamin e studimit)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Ne kete IAL, behen perpjekje per te mbeshtetur personelin akademik ne rritjen e metejshme te aftesive profesionale mesimdhenses dhe sidomos ne drejtimin didaktik te aftesimit te tyre. Sidomos ka vemendje per krijimin e kushteve optimale gjate mesimdhënies. Ne varesi te lendes apo modulit qe zhvillon stafi akademik perdor ne oren e mesimit metoda interaktive, projektore, slajdera, video te regjistruara nga veprimtaria</p>

Naxmi Koci
Arso

[Signature]

	private e pedagoqeve, duke e bere mesimin aktiv, terheqes dhe me rezultate konkrete. Nderkohe Institucioni nxit dhe inkurajon personelin akademik per permiresimin e mesimdhenies dhe kryerjen e studimeve te metejshme per rritjen e nivelit shkencor te tyre dhe fitimin e titujve apo te gradave shkencore. Ne pranine e ekipit qe vizitoi kete IAL, ju kerkua nje pedagogu qe jepte mesim aty qe te kryente studimet e Doktoratures ne Spanje, ku institucioni merrte persiper te gjitha shpenzimet per kryerjen e studimit, ato te udhetimit dhe te jeteses se kandidatit per aq kohe sa zgjaste studimi. Jane marre persiper e sponsorizuar nga institucioni shume studime e botime qe jane kryer deri tani. Eshte fakt qe ky institucion boton nje Reviste shkencore me nivel te mire shkencor, tirazh te mjaftueshem dhe qe njihet e lexohet ne te gjithe vendin. Te gjitha perparimet e stafit akademik ne kete fushe njihen dhe promovohen sidomos brenda institucionit, por edhe jashte tij. Kjo gje eshte e pasqyruar edhe ne pjesen perkatese te raportit vjetor te IAL I cili publikohet ne faqen e tij si dhe i eshte derguar MASR. (Evidenca 55) (Evidenca 17)			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Infrastuktura e ngritur per zhvillimin e procesit mesimor te programit te studimit Ndhimes Dentar ne Kolegjin Universitar REALD, eshte e bollshme dhe e kompletuar. Duhet nenvizuar se IAL ne kete drejtim ka kryer investime serioze dhe me perspektive. Hapesirat per realizimin e procesit mesimor, auditoret, labororet kabinetit i pajisur me manekine, salla e bibliotekes, nyjet hidrosanitare etj jane te gjitha ne kondicionet e duhura per zhvillimin e mesimit dhe perballojne nje kontigjentt disa here me te madh te studenteve nga ai qe eshte aktualisht ne pergatitje. Mjediset mesimore dhe hapesirat ndihmese jane te pastra, te ndricuara e te ajrosura mjaft mire, eshte i paisur dhe funksionon normalisht sistemi i ngrohjes e ftohjes se ambjentit. Ambjentet mesimore jane te paisur me video projektore dhe kane bazen e nevojshme didaktike per zhvillimin normal te procesit mesimor. Pervec labororeve te lendeve baze, ka laborore te praktikave profesionale te specialitetit ne kondicionet e duhura teknike dhe te pajisur me aparaturata e bazen e nevojshme material per zhvillimin normal te procesit mesimor teorik dhe praktikave profesionale. Ne institucion eshte ngritur e fillon se shpejti nga puna edhe nje Klinike Dentare e pajisur me aparatura te reja e bashkekohore qe jane

Naxmi Koci
Arbore



	<p>prodhim i viteve te fundit dhe kjo i krijon lehtësi te vecante procesit mesimor, pasi krijon lehtësira per zhvillimin e praktikave mesimore ne institucion, pra per realizimin me cilesi te procesit mesimor. <i>(Evidenca 34)</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Studentet dhe personeli akademik ne kete IAL, kane ne dispozicion te tyre nje kabinet te bollshem te IT dhe gjithe infrastrukturen e nevojshme te teknologjise se informacionit qe eshte e gatshme dhe ne funksion te procesit mesimor gjate gjithe diteve te javes. Eshte hartuar nje rregullore e brendshme e institucionit per perdorimin e infrastruktures se teknologjise se informacionit. Salla e IT ka nje numer vendesh te kompletuara qe eshte dukshem me i madh se numri i studenteve qe frekuentojne aktualisht dhe eshte ne dispozicion te studenteve dhe te stafit akademik edhe jashte orarit te mesimit. Ajo eshte e hapur dhe e aksesueshme cdo dite nga ora 8:00 deri ne oren 16:00. Pervec shfrytezimit per qellime te lendeve te tjera mesimore ne sallën e IT zhvillohet edhe lenda e informatikes, pasi ne kete program ka nje lende qe jep njohuri edhe ne kete fushe. Ne kete institucion jane ne funksion edhe sistemet e komunikimit te brendshem me ane te e-mailit me ane te adreses emer.mbiemer@unireald.edu.al. Eshte ne funksion edhe platforma google classroom, videoprojektore ne cdo sale etj. <i>(Evidenca 37) (Evidenca 38)</i></p>
<p>Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Per realizimin e programit te studimit qe ofrohet ne kete institucion, jane bere perpjekje te mira ne drejtim te sigurimit te literatures baze dhe ndihmese qe lidhet me kete program. Eshte siguruar literatura e nevojshme qe eshte e botuar deri sot ne gjuhen shqipe per kete program. Ky eshte nje problem ende jo plotesisht i zgjidhur ne shkalle vendi pasi botimet e literatures profesionale stomatologjike ose mungojne, ose jane te viteve te shkuara dhe gradualisht po humbasin karakterin aktual te informacionit. Gjithesesi, ne kete institucion ishin gjendje mjaft tekste baze dhe monografi qe jane ne dispozicion ne literature tone profesionale ne gjuhen shqipe. Ne institucion ka funksionuar edhe nje menyre tjeter e sigurimit te literatures baze dhe e informacionit shkencor ne gjuhen tone. Duke qene se kurikula e ketij programi jep njohuri te pergjithshme mjekesore, por edhe te karakterit specifik te Ndhmesit dhe Asistentit dentar, disa nga mesimdhenesit kane pergatitur leksione specifikisht per kete program, te cilat ndodhen te shtypura ne Sekretarine e Fakultetit dhe u shperndahen studenteve pa pagese. Literatura fizike, eshte per tu vleresuar edhe ajo pjese e saj ne gjuhe te huaj qe ndodhej prezente ne biblioteke dhe e aksesueshme nga studentet dhe stafi akademik. Ne kete institucion biblioteka e tij disponon rreth 1000 tituj librash mjekesor ne gjuhet te huaj dhe sasia e tyre lidhur me programin e ofruar duhet konsideruar e mjaftueshme. Bibiloteka ka numer te mjaftueshem vendesh studimi, kushte te pershtateshme dhe orari i saj eshte i pershtashem per kedo qe ka deshire ta shfrytezoje ate. <i>(Aneksi 20- Syllabuset e programit Ndhmes Dentar), (Aneksi 46- Lista e teksteve ne Biobliotke/ aneksi 47.</i></p>

	<i>Lista e librave online)</i>
<p>Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Ne kete institucion biblioteka ka akses edhe ne literature mjeksore ne rruge elektronike, eshte e abonuar dhe siguron pa veshtiresi on-line cdo liber te ketij profili dhe qe lidhet me permbajtjen e programit, ose te fushave te ngjashme apo te peraferta te ketij programi. Kjo jep garanci per pajisjen e studenteve me njohurite e duhura qe permban ky program studimi. Linku i aksesit eshte https://unireald.edu.al/biblioteka/. Per kete arsye, per ti ardhur ne ndihme vazhdimisht realizimit te ketij programi, biblioteka e institucionit dhe laboratory i IT jane te hapura e ne dispozicion te studenteve dhe te stafit cdo dite nga ora 8.00 deri ne oren 16.00 <i>(Vizita ne IAL)</i></p>
<p>Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Infrastruktura e nevojshme laboratorike per kete program studimi eshte e plotesuar ne sasi te nevojshme dhe sipas kerkesave te tij specifike. Ajo krijon mundesine e realizimit ne kushte optimale te detyrave te programit, detyra kursi apo studime specifike te karakterit profesional. Laboratori i pergatitjes paraklinike te studenteve eshte i pajisur me cdo gje te nevojshme dhe simulon situaten konkrete te punes me pacientete pasi ka manekine profesionale, unite me turbine e cdo gje tjeter si ne nje kabinet dentar real. Klinika dentare qe eshte ngritur kohet e fundit kryesisht ne dispozicion te procesit mesimor do te pranoje e mjekoje edhe paciente reale ku studentet mund te pergatiten per te punuar realisht ne rolin e primarit apo te ndihmesit dhe kjo e ben te realizueshem pa asnje pengese kete program studimi. E gjitha kjo infrastrukture eshte e gatshme, ne funksion, shumica ne gjendje krejt te re dhe plotesisht funksionale dhe qe shfrytezohet pa asnje pengeses nga studentet e ketij programi studimi. Gjithashtu pervec 7 uniteve te reja dhe turbinave dentare per kliniken e re shoqeruar me te gjitha paisjet e nevojshme te kabinetev dentare te kohes sone, ka shtuar edhe 30 kompjutera te rinj ne laboratorin e informatikes. Mendoj se shkallla e pajisjeve te sallave dhe te laboratoreve qe lidhen me kete program studimi jane bere pa kursyer nga ana e IAL. Kjo jep garanci per kete program studimi, por mund te jete nje baze e mire per te ne realizimin e objektivave te tij ne te ardhmen. <i>(Evidenca 34)</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Ne IAL REALD, ne funksion te procesit mesimor dhe te edukimit profesional, personeli akademik dhe studentet e ketij programi perdorin platform on-line (elearning). Ne institucion ishin ne perdorim Manuali per studentet Google classroom, Manuali per programin OBS per regjistrim audio e video si dhe Manuali per pedagoget Google classroom.</p> <p>Lidhur me kete problem ne kete IAL, me 20.03.2020, eshte leshuar urdheri nr. 32 te rektorit te tij me titull “Per zhvillimin e procesit mesimor on-line ne Kolegjin Universitar REALD”. Ky urdher tregon edhe format e mundshme te sistemeve virtuale te komunikimit si Google classroom, Ehats App, Viber, Skype etj. <i>(Evidenca 60) (Evidenca 61) (Evidenca 62) (Evidenca 63)</i></p>

Naxmi Koci
Arso

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.</p>	<p>KU “REALD” ka organizuar në nivel institucional struktura të posaçme për monitorimin dhe rritjen e cilësisë së programit të studimit Ndihmes Dentar (NJSBC). Ajo është përberese për sigurimin e cilësisë dhe bashkëpunon me njësinë kryesore dhe ato baze për organizimin e veprimtarive të saj në funksion të përmirësimit të cilësisë, për të dhënat që nxjerr gjatë veprimtarisë së saj dhe problemet që evidenton. Ajo prezanton ato tek njësinë baze dhe ajo kryesore dhe është pjesë efektive e procesit të zgjidhjes së tyre. Në përberje të saj bëjnë pjesë 5 anëtarë, nga të cilët 3 janë personel akademik, një përfaqësues i Keshillit studentor dhe një ekspert i jashtëm. NJSBC ka mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje. Kjo njësi ka kryer aktivitete të larmishme në funksion të rritjes së metejshme të cilësisë së mesimdhënies si trajnime, ore mesimi të hapura, shkembime përvojash, etj. Ajo ka kryer anketime të programuara jo më pak se dy herë në vit ku ka marrë në mënyrë anonime mendimet e studenteve për mjaft procese që lidhen me mesimdhënien si përmbajtja e kurikulës, mendime lidhur me planin mesimor, vlerësimi i studenteve lidhur me mënyrat e mesimdhënies, aftësitë e pedagogëve në leksione të praktika, objektiviteti i tyre në vlerësime gjatë vitit dhe në provime të mjaft çeshtje të tjera. Në këtë mënyrë mundet që të vëzhgojmë pyetësorë të tilla si dhe disa përgjigje të dhëna nga studentët. Të dhënat që përmbajnë këto anketa pas përgjigjes që kanë dhënë studentët janë grumbulluar e përpunuar dhe prej tyre janë nxjerrë detyra të metejshme për përmirësimin e cilësisë së mesimdhënies. Këto të dhëna u janë dërguar njësinë kryesore dhe asaj baze dhe kanë shërbyer si indicie për programe pune dhe rritjen e metejshme të cilësisë së realizimit të programit. <i>(Evidenca 25)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësinë kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Njësinë kryesore dhe ajo baze janë përgjegjëse për cilësinë e mesimdhënies në IAL REALD. Ato kanë punuar sistematikisht për rritjen e vetëdijes së personelit akademik dhe ndihmes, po ashtu edhe të studenteve, lidhur me rritjen e cilësisë në programin e studimit që ofrohet. Në statutin e Institucionit dhe rregulloren e programit të studimit janë të percaktuara qartë detyrat kryesore lidhur me procesin e mesimdhënies dhe sigurimin e cilësisë së tij, aktivizimin e studenteve në kërkimin shkencor, ku personeli ndihmes (Ndihmes Dentar) në praktiken e përditshme ka një rol të rëndësishëm të real dhe është pjesë aktive e</p>

Naxmi Koci
Arbore

B

	<p>ketij procesi. Ne to jane te percaktuara qarte edhe te gjitha detyrat e tjera qe lidhen me mesimdhenien dhe sigurimin e cilesise se saj. Njesia baze dhe Pergjegjesi i saj jane autoriteti i ngarkuar me gjithe ecurine dhe cilesine e mesimdhenies. Pergjegjesi i Departamentit eshte autoriteti me i larte akademik ne detyra dhe kompetenca per cilesine e realizimit te programit te studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ai drejton punen per hartimin e planeve mesimore dhe programeve te lendeve qe permban programi, kontrollon ato dhe monitoron zbatimin e tyre. - Ndjek dhe kontrollon pjesmarjen e studenteve si ndihmes ne grumbullimin e te dhenave dhe realizimin e procesit te kerkimit shkencor. - Ngre komisionet e provimeve dhe monitoron procesin e vleresimit te dijeve. - Organizon analiza te aspekteve te punes mesimore gjate vitit dhe analiza semestrale e vjetore lidhur me ecurine e punes per realizimin e sukseshem te programit dhe mjaft detyra te tjera qe jane te percaktuara qarte edhe ne rregulloren e programit te studimit Ndhimes Dentar. <i>(Aneksi 11- Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekesore), (Aneksi 9- Rregullore e progrmamit te studimit)</i>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmesakademik jane pergjegjes per zbatimin e programeve te studimeve dhe angazhohen per përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>Personeli akdemik dhe ai ndihmes, te drejtuar nga drejtuesi i Departamentit, jane pergjegjes per realizimin e programit te studimit qe eshte implementuar ne kete IAL. Ata jane te angazhuar ne veprimtarine e perditshme te tyre per ecurine e tij dhe realizimin cilesor te gjithe aktivitetit mesimor e praktikave profesionale. Ka nje interesim te vecante nga ana e stafit mesimdhenes per permiresimin e aftesive mesimdhenes dhe per futjen e metodave te reja e inovative te mesimdhenes. Ne kete program me karakter profesional ka pedagoge me aftesi te spikatura dhe experience te pasur klinke, te perfshire ne kualifikimin shkencor pasuniversitar, qe jane ne procesin e pergatitjes dhe te mbrojtjes se Doktorates si dhe te tjere qe kane kryer Spa ne profile te stomatolgjise qe lidhen me permbajtjen e ketij programi studimi. Veprimtaria e tyre per kualifikimin e vazhdueshem shkencor, pjesmarrja ne konferenca e kongrese, aktivizimi ne studime me karakter shkencore dhe deshira e pjesmarrja e tyre ne veprimtari botuese te specialitetit jane per tu vleresuar. Ky institucion i arsimit te larte boton nje Buletin shkencor periodik qe eshte interesant per nga permbajtja, ka nivel te mire shkencor dhe vleresohet edhe ne ambjentet shkencore te institucioneve te tjera te arsimit te larte ne vend. Studente e ketij programi studimi gjithashtu jane motivuar qe te jene pjese e aktiviteteteve shkencore qe jane zhvilluar brenda dhe jashte institucionit. Ata jane bere pjese e studimeve shkencore qe kryhen aty ne rolin e ndihmesit dhe qe ndihmojne ne grumbullimin dhe administrimin e te dhenave me karakter shkencor. Te gjitha keto jane organizuar ne pershtatje me natyren specifike te ketij programi me karakter profesional. <i>(Evidenca 53)</i></p>

<p>Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p>	<p>Strukturat dhe njesite e IAL kane trajnuar vazhdimisht personelin akademik per te permiresuar aftesite mesimdhene dhe per te implementuar metoda te reja inovative ne kete process. Peverc kualifikimeve shkencore qe zoterojne pedagoget dhe i gjithë stafi akademik i angazhuar per realizimin e ketij programi, ka qene pjesemarres aktiv ne te gjitha format qe perdoren per kualifikimin e metejshem te tij, si brenda apo jashte institucionit. Ne fund te cdo viti mesimor stafi mesimdhene plotesojne nje formular te avancimit akademik, keshtu ky process eshte i monitoruar dhe ndiqet hap pas hapi zhvillimi i tij dhe shkallet ne ngjitje. Ne institucion organizohen cdo vit konferenca shkencore dhe trajnime te shpeshta ne funksion te rritjes se shkalles se pergatitjes se stafit mesimdhene dhe te rritjes se cilesise se pervesimit te dijeve nga ana e srudenteve. Te gjitha keto veprimtari jane te parashikuara ne planet e punes vjetore te njesise kryesore dhe te asaj baze dhe ne rregulloren e kerkimit shkencor te IAL. Punimet shkencore qe zhvillohen ne kete institucion, midis te cilave ka edhe te tilla qe lidhen me cilesine e mesimdhene, botohen ne Buletinin periodik te tij dhe shfrytezohen jo vetem nga stafi akademik itij, por edhe me gjere. Botimi i punimeve shkencore te stafit akademik behet pa pagese dhe gjithë fatura e shpenzimeve per punen studimore shkencore, perballohet nga ana e institucionit. Studentet mund te marri pjese lirisht ne te gjithë aktivitetet shkencore qe zhvillohen ne IAL ose te informohen rreth tyre permes faqes se tij: https://unireald.edu.al/category/aktivitete - promovuese/ (Evidenca 35) (Evidenca 33) (Evidenca 50)</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Metodat e mesimdhene qe perdoren ne kete institucion, sidomos ato qe lidhen me praktikat profesionale shkojne paralelisht me ndryshimet dhe zhvillimin e metodave te reja te diagnostikimit e te mjekimit ne mjekesi. Ne menyre te vazhduar behet testimi i metodave te reja ne mesimdhene dhe analizohen efektet e pritshme te tyre. Te gjitha keto raportohen ne strukturat përgjegjese, ne njesine baze e ate kryesore dhe te gjitha ato qe rezultojne efektive, pervesohen si te tilla per tu perdorur ne vazhdimesi. Permes menyrave bashkekohore te zhvillimit te mesimit, duke perdorur projektore, me ane te videove, ne Poëer Point stafi akademik u krijon mundesine studenteve te marrin njohuri praktike te qendrueshme dhe pervesojne me me lehtesi principet teorike te specialitetit ne te cilin pergatiten. Departamenti perkates vazhdimisht kontrollon dhe monitoron aktivitetin mesimdhene e po ashtu pedagoget vazhdimisht raportojne per rezultatet e pritshme dhe implementimin e metodave te reja. Kjo ka sjelle qe nga viti ne vit te kete permiresime te dukshme cka u konstatua gjate vizites ne institucion dhe nga konsulta e organizuar me studenet qe po vazhdojne kete program studimi dhe ata qe e kishin perfunduar ate. Kete proces e ndjek me vemendje edhe NJSBC e cila peverc kontakteve direkte me studentet, ka hartuar pyetesore dhe ka realizuar intervista ne kushte anonimati, rezultatet e te cilave jane perpunuar e konkluzionet e tyre njihen dhe sherbejne si program pune per te ardhmen. Te dhenat e ketyre intervistave, pyetsoret dhe formularet perkates ruhen dhe na u</p>

Naxmi Koci
Arbaci



	vune ne dispozicion gjate vizites atje. Permbledhja kryesore e tyre eshte e pasqyruar edhe ne raportin vjetor te institucionit dhe ne Raportin vjetor te NJSBC dhe ndodhen edhe ne dosjen perkatese qe ka paraqitur IAL per shqyrtim. (Evidenca 17) (Evidenca 30) (Evidenca 32)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimi e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësiwe profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.	Njesia kryesore dhe ajo baze te IAL kane rregulloret e tyre te funksionimit te aktivitetit te tyre si dhe nje rregullore te posacme per kete program studimi. Ne rregulloren e programit te studimit per Ndhimes Dentar jane te percaktuara te gjitha kerkesat qe lidhen me zbatimin e ketij kriteri. Verehet se jane bere perpjekje serioze qe te behet ne menyre te perditeshme vleresimi i dijeve te studenteve, sidomos i aftesive te tyre profesionale. Ne nenin 58 te rregullores se pergjitheshme jane te precizuara qartesisht te gjitha menytrat e vleresimit te dijeve dhe te vleresimit te studenteve ne vazhdimesi dhe ne fund te vitit. Po keshtu ka rregulla te qarta lidhur me kontrollin e dijeve dhe vleresimin e aftesive profesionale te studenteve ne rregulloren e posacme te ketij programi studimi. Rregulloret jane publike dhe gjenden edhe te publikuara on-line ne faqen e elektronike te IAL ne adresen www.unireald.edu.al . Konstatohet se jane zbatuar rregullisht kerkesat e rregulloreve per vleresimin e dijeve te studenteve. Kjo gje u konfirmua nga kontakti direkt me ta dhe nga pergjigjet e pyetjeve te dhena gjate anketimeve te bera gjate vitit akademik 2019-2020. Kete e bejne te besueshme edhe fakti se IAL ka hartuar nje rregullore tjeter te vecante me rregullat dhe kerkesat e zhvillimit te provimeve. Nuk konstatohet qe te kete kontestime ne kete drejtim, megjithese rregullore perkatese e kane parashikuar kete mundesi dhe garantojne zbatimin e plote te saj. (Evidenca 5) (Evidenca 7) (Evidenca 44)
Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi dhe vleresimi i dijeve, njohurive dhe shprehive profesionale qe fitohen cdo dite, po ashtu testohen ne menyre te perditeshme dhe ne cdo ore mesimi e praktike. Para fillimit te cdo procedure praktike, pedagogu ose tutori i praktikës monitorojne nivelin e dijeve te studenteve, kontrollojne menyren se si do te procedohet praktikisht, protokollin e procedures perkatese dhe pasi binden se ka qartesi per anen teorike te problemit, vazhdojne me tej me zbatimin e seancave e procedurave praktike. Keto kontrole te njohurive behen ne seminare, por edhe ne

Naxhi Koci
Arbaci

[Signature]

	<p>laboratorin e praktikave profesionale qe ka institucioni, ne Kliniken stomatologjike qe ofron sherbime aty dhe njeherazi pergatiten studentet dhe ne kabinetet e sherbimit privat ku studentet kryejne praktikat profesionale direkt ne sherbim te pacienteve dhe me te cilet IAL ka marreveshje te rregullta bashkepunimi. Ne te gjitha keto raste studenti e ka mundesine qe te shpalose njohurite dhe aftesite profesionale te fituara gjate procesit te mesimit apo te praktikës. Testimi dhe vleresimi i njohurive, dijeve dhe shprehive praktike te fituara nga ana e studenteve, konsiderohet nje moment kyç ne punen e pedagoqeve, te cilet e verifikojne ate ne te gjitha rastet e mundeshme, sipas parimeve te njohura didaktike. Ata i kushtojne rendesi te posacme jo vetem kontrollit te perditshem te dijeve, por edhe hartimit te testit ne provime kontrolli, semstrale apo dhe vjetore qe pyetjet te jene pergjithesuese dhe te shprehin esencen e dijeve per ate problem, fenomen apo procedure praktike. Zakonisht ato hartohen ne menyre koncize, me alternative pergjigjeje, duke i dhene mundesi studentit te beje analize e te diferencojë fenomenet dhe te jape pergjigjen e sakte. <i>(Evidenca 44)</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>Ne permbajtjen e te gjitha syllabuseve eshte percaktuar edhe menyra e kontrollit te dijeve dhe titullari i lendes ka percaktuar se kjo mund te behet me goje, me shkrim, ose i kombinuar per lendet me karakter profesional dhe qe jane pjese e formimit karakterizues te programit. Ne fillim te cdo lende studentet jane informuar me detaje lidhur me keto procedura dhe kerkesat specifike per cdo lende apo modul.</p> <p>Vleresimi eshte konsideruar nje process kompleks ku te gjitha etapat e mesimit nga dita e pare tek e fundit kane rendesi dhe jane pjese e ketij procesi. Pjesmarrja rregullisht ne mesim dhe ne pergjigje per pyetjet e drejtuara vleresohet derin 30%, pra eshte pjese e vleresimit qe mund te sigurohet para dites se provimit. Per te gjitha etapat e metejshme studentet jane te mire informuar. Kane % e tyre ne vleresimi e dijeve detyrat e kursit, provimet e pjeseshme per kapituj a pjese te vecanta te lendes dhe provimi final me te cilin studenti mund te siguroje deri ne 70% te pikeve te vleresimit te tij. Specifikat e vecanta per cdo lende a provim, per kontrollat e ushtruara gjate vitit per pjese te vecanta te programit, dita apo jave e provimit, konvertimi i pikeve te fituara ne note, apo detaje te tjera shpjegohen qe ne fillim te lendes nga e studentit dhe ishin te qarta nga ana e tyre <i>(Aneksi 12- Rregullore e diplomimit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Testimi dhe vleresimi i njohurive dhe aftesive profesionale ne IAL eshte ndertuar ne menyre te drejte dhe transparente. Lidhur me kete proces nuk u konstatua ndonje e mete apo verejtje nga ana e studenteve. Edhe ne pergjigjet anonime qe jane bere gjate anketimeve nuk eshte shenuar gje e vecante ne kete drejtim. Ka funksionuar nje praktike e njohur edhe ne institucione te tjera te arsimit te larte dhe qe eshte e sanksionuar edhe ne rregulloren e zhvillimit te provimeve qe ka hartuar e zbaton ky institucion. Testet e kontrollit te njohurive te studenteve, para fillimit te procesit te testimit, sekretohen nga ana e sekretarise mesimore, ku cdo</p>

	<p>studenti i caktohet nje kod sekret. Pedagogu e ka korigjuar testin pa ditur gjeneralitetet e studentit dhe kujt i perket ai dhe ka shenuar vleresimin perkates per cdo test. Lista e pikeve qe i korrespondon kodit perkates te cdo studenti i eshte dorezuar sekretarise e cila ka bere verifikimin e pikeve ne perputhje me kodin sekret per cdo rast. Ne fund pas ketij rakordimi eshte hartuar process verbali i vleresimit te studenteve i cili eshte i nenshkruar nga jo me pak se 2 pedagoge dhe sekretaria mesimore. Proces verbali mban edhe nenshkrimin e shefit te departamentit ose te dekanit te fakultetit. E gjithë kjo procedure e vleresimit dhe kontrollit te njohurive eshte e pershkruar ne rregullore e institucionit per provimet dhe eshte pjese e dosjes se paraqitur per vleresim e akreditim te programit. <i>(Evidenca 44)</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vleresimi i njohurive dijeve dhe aftesive profesionale te studenteve, vleresohet me komisione te ngitura enkas sic percaktohet edhe ne rregulloren perkatese. Perfundimet e dhenave shoqerohen me sqarime e komente pas te cilave te gjithë kandidatet mbeten te qarte dhe perfitojne edhe ne oren e fundit nga ndonje gabim i mundshem, apo ndonje informacion jo i sakte. Sqarimet ne grup i vlejne te gjithë pjesmarresve ne provim dhe ka funksionuar normalisht. Pergjegjesi i Departamentit ne bashkepunim me Dekanin e Fakultetit kane percaktuar daten e provimeve semestrare apo vjetore dhe komisionet e provimeve sic percaktohet edhe ne rregulloren e institucionit dhe ate te provimeve. Komisioni i Diplomimeve eshte ngritur me Urdher te vecante te Dekanit te Fakultetit per cdo njesi baze. Te gjitha keto procedura jane te percaktuara qarte ne rregulloren e IAL, rregulloren e njesise baze qe eshte pergjegjese per realizimin e programit si dhe ne rregulloren e diplomimit qe jane pjese e dosjesjes se paraqitur per tu vleresuar. Procesi i kontrollit te njohurive eshte i pracaktuar me detaje edhe ne rregulloren e zhvillimit te provimeve qe eshte gjithashtu pjese e kesaj dosjeje. <i>(Aneksi 12- Rregullore e diplomimit), (Aneksi 11- Rregullore e FSHM)/ (Aneksi 9- Rregullore e pergjithshme KUR)</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Rezultatet e kontrollit te dijeve dhe te aftesive profesionale bazohen ne procedura te rregullta dhe vleresimet kane qene te merituar. Keto rezultatet u jane dhene studenteve ne kohe sipas percaktimeve qe ka ne rregulloren perkatese. Studenteve u eshte siguruar e drejta per tu njohur me vleresimin dhe rezultatin qe kane arritur. Ata e kane te garantuar kerkesen per rishikim te vleresimit te bere dhe e kane ushtruar ne raste te vecanta, pas te cilave kane mbetur te qarte dhe jane dakortuesuar me rezultatin e arritur. Shkalla e pervesimit te programit mesimor ne kete program studimi vleresohet me note sipas sistemit prej 10 notash, nga 1-10 dhe nota me e ulet kaluese eshte 5 (pese). Te gjitha proces verbalet e provimeve qe u kontrolluan u gjeten te rregullta dhe ato ruheshin me pergjegjesi ne sekretarine mesimore. Gjate vitit kontrolli i dijeve ka kaluar edhe permes formave te tjera si ai me pike, te cilat detyrimisht kthehen ne note sipas nje raporti te caktuar dhe te barabarte per te gjithë</p>

Naxmi Koci
Arso



	<p>studentet.</p> <p>Studentet kane te drejte te ankohen per rezultatin perfundimtar te provimit, me ane te nje kerkese me shkrim qe i paraqitet pergjegjesit te departamentit brenda 24 oreve nga shpallja e rezultatit te provimit i cili ka detyre te beje verifikimet e duhura dhe te vere ne dijeni dekanin. Dekani brenda 24 oreve nga koha qe merr dijeni per ankesen ngre nje komision ad-hok i cili ben verifikimin perfundimtar te ankeses se studentit dhe jep vleresimin perfundimtar te provimit. E drejta e studentit per te kerkuar verifikimin e rezultatit ne provim, apo rivleresim te tij eshte e siguruar me rregullore dhe kjo zbatohet korrekt. Raste te tilla gjate vitit akademik ka patur, por vetem jane bere sqarime, ndersa rivleresime te provimit nuk ka qene e nevojshme te behen. <i>(Evidenca 5)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim të njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënës për programet me karakter profesional.	Ky proces është parë me përgjegjësi dhe ai ze fill që në përgatitjen e një kurikule cilesore të programit. Në hartimin e saj dhe me pas në realizimin me kujdes në praktike është patur parasysh që garantojnë njohuri të plota teorike dhe praktike profesionale që të mund të zbatohen pa vështirësi në aktivitetin praktik të kandidatëve që përgatiten në këtë program. Kjo sigurohet për të patur në tregun e punës specialiste të aftë që i përgjigjen kërkesave të tregut dhe orjentojnë pa vështirësi në praktike. Gjate gjithë implementimit të programit studentet janë angazhuar në një punë intensive, të vazhduar për formimin e tyre praktik dhe krijimin e shprehive të nevojshme profesionale gjate aktivitetit praktik. Nevoja e tregut të shërbimit stomatologjik për këtë kategori specialistesh është dukshme. Në mendojmë se ndersa ka një tendencë inflacioni në përgatitjen e specialistëve që kryejnë studime të integruara dhe ka një numër të konsiderueshëm IAL-esh që e realizojnë këtë, shërbimi ka nevojë pikerisht për specialiste të këtij niveli që të punojnë në ekip dhe të kryejnë detyrat e ndihmesit a të asistentit. Kjo është arsyeja që në këtë program studimi një pjesë të konsiderueshme të tij e zënë praktikën profesionale në klinikë e kabinete të shërbimit stomatologjik privat. Aty studentet kanë prekur nga afër problemet teknike, por edhe mënyrën e organizimit të këtij shërbimi. Duke vepruar në këtë mënyrë, një pjesë jo e vogël e këtyre studentëve ka patur oferta për të punësuar qysh gjate periudhës së studimeve dhe pas përfundimit të tyre kanë të sigurte një

Naxmi Koci
Arçis

	<p>vend pune ne treg. Kjo mendojme se ka ndodhur pasi shkalla e pergatitjes se studenteve u pergjigjet kerkesave te kohes dhe realizimi i ketij programi i ka arritur rezultatet e pritura dhe objektivat e percaktuara ne fillim te tij. <i>(Evidenca 1)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Ky program studimi per Ndhimes dentar qe ka karakter profesional, pais me njohuri te pershtateshme teorike e profesionale teknike dhe siguron aftesi te mjaftueshme te specialistit ndihmes ne sherbimin dentar. Ai jep njohuri te nevojshme per te realizuar punen ne ekip, pais studentet me etiken e nevojshme dhe artin e komunikimit me pacientet dhe koleget e eproret.</p> <p>Ne te gjitha lendete behen perpjekje qe te krijohen njohuri e shprehi te qendrushme per nderveprimin dhe zgjidhjen e problemeve si ekip. Kjo eshte patur parasyshe qe gjate hartimit te kurikules se studimit ku jane planifikuar elementet e nevojshem gjate saj. Ka nje modul te vecante ne kurikulen e ketij programi studimi te emertuar “Aplikime kumpjuterike dentare” qe zhvillohet ne vitin e pare dhe realizon 4 kredite ne kete program. Keshtu mendojme se jane te kombinuara e realizohen ne menyre te kenaqeshme edhe formimi profesional dhe etik ne kete program studimi, ashtu edhe njohurite ne fushen e teknologjise se informacinit me kerkesa specifike te sherbimit dentar. Ky program studimi i ciklit te pare i permbush keto kerkesa, eshte brenda standartit te nevojshem te kerkesave te kohes qe ka tregu per kete kategorii specialistesh. <i>(Evidenca 13)</i></p>
<p>Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Ne kete program studimi mesimdhjenja realizohet ne menyre te tille qe te siguroje kompetenca e aftesi profesionale per pune te pavarur, por edhe per te zgjidhur problem e situata te vecanta, brenda nivelit te formimit qe jep realizimi me sukses i tij. Programi u jep njohuri studenteve qe te vene ne jete dijet e firuara duke garantuar ne praktike plotesimin e marveshtjeve me punedhenesit dhe aktoret e biznesit dhe perballimin me sukses te kerkesave te specialitetit te fituar pas perfundimit te tij. Per kete personeli akademik ka kombinuar format e mesuimdhenges me institucionet bashkepunuese per te mundesuar formimin profesional te studenteve sa me prane kushteve reale te praktikës se ketij sherbimi. Ne institucion eshte kembngulur vazhdimisht per zbatimin e metodave te reja te mesimdhenges, por duke i kombinuar ato me kushtet reale te praktikës mjeksore te perditeshme. Gjithnje per zgjidhjen e situatatve te thjeshta apo te nderlikuara, eshte synuar ne terheqjen e mendimit te studenteve duke i bere ata objekt dhe subjekt te procesit te te nxenit. Kjo ka rritur me tej pavaresine dhe qendrushmerine e dijeve te fituara. Marreveshtjet e bashkepunimit me institucinet perkatese u gjeten te rregullta. Personeli akademik ka bere perpjekje ne vazhdimesi per te kombinuar punen me to, duke gershetuar dijet e karakterit teorik, me ato te praktikës e rutines se perditeshme te sherbimit, ne kushte plotesisht reale e te rastesishme sic i ka praktika mjeksore ne sherbimin e saj, e gjitha kjo per te krijuar nje pergatitje sa me reale, efektive dhe te qendrushme te studenteve.</p>

	<i>(Evidenca 42)</i>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Eshte bere praktike e zakonshme pune ne kete IAL qe ne fund te cdo lende apo moduli, personeli akademik ka bere vleresimin e rezultateve te arritura dhe ka shqyrtuar aftesit e fituara nga studentet. Jane shqyrtuar kompetencat profesionale dhe aftesite e fituara ne manipulime te ndryshme sipas permbajtjes qe ka syllabusi i lendes apo modulit perkates. Me kete rast jane evidentuar ceshtjet me te rendesishme qe jane konstatuar gjate ketij procesi dhe jane keshilluar studentet per implemntimin e plote te tyre. Ne fund te semestrit, sidomos te vitit akademik, njesia baze e ketij institucioni qe eshte e ngarkuar per realizimin e tij, ka bere analize vjetore mbi arritjet ne realizimin e programit te studimit dhe plotesimin e objektiveve te tij. Eshte bere bilanci i rezultatetve te priteshme te te nxenit dhe ai i aftesimit professional per cdo student dhe per kete ka dokumentacion te shkruar dhe qe ruhet nga ana e njesise baze. <i>(Evidenca 31)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Kolegji Universitar REALD ka hartuar procedura te posacme e te qarta ne funksion te procesit te diplomimit te studenteve. Ato jane bere publike, njihen nga studentet dhe personat e interesuar dhe garantojne mbeshtetje te plote nga ana e institucionit per permbushjen e detyrimeve permbyllese te programit dhe procesin e diplomimit te studenteve. Ne dispozicio te tyre IAL ka hartuar dhe ka vene perdorim nje manual per detyrat e studentit ne kete periudhe dhe disonon nje rregullore enkas per diplomimin e studenteve. Gjithashtu IAL ka mbajtur regjistra te posacem zyrtare per studentet e diplomuar qe i ka plotesuar ne fund te vitit akademik. Keto regjistra u kontrolluan dhe u gjeten ne rregull dhe sipas kerkesave te ligjit. Ne institucion u gjeten per kete problem:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Regjister i rezulteteve te studenteve dhe 2. Regjister i evidentimit te te dhenave te studenteve (AMZA). Ky institucion ka te dhena edhe per studentet qe jane diplomuar me pare, por ne kete program studimi ende nuk jane paisur me Diplome studentet qe kane studjuar ne kete vit akademik. <i>(Aneksi 39,40- Te dhena per regjistrimin e studenteve), (Vizita ne IAL)</i>
<p>Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>Pergatitja e Diplomes dhe realizimi i detyrimeve permbyllese te ketij pragrami me ane te pergatitje se nje teme diplome, nuk eshte e obliguar ne kete program studimi. Per natyren qe ka dhe karakterin profesional, ky program eshte parashikuar te permbyllet me nje provim perfundimtar qe realizohet ne fund te programit dhe vleresohet me 5 kredite. Ka nje praktike te mirorganizuar per kete proces, ka dokumenta te hartuara qarte dhe te bera publike dhe qe njihen nga ana e studenteve. Ato jane te aksesueshme si ne hard copy, ashtu edhe ne versionin on-line.</p> <p>Ky IAL, megjithate nuk u privon studenteve te drejten e mbrojtjes se Diplomes, kur ata kane rezultate te mira gjate procesit mesimor dhe praktikave profesionale dhe kur e deshirojne nje gje te tille. Per keto raste, qe praktikisht jane ne pakice, ka dokumentacion te qarte, caktohen</p>

	udheheqes te Diplomes dhe ka manual perkates per zgjedhjen e temes, pergatitjen e Diplomes dhe mbrojtjen e saj. Ky manual na u duk interesant dhe mund te jete me vlere edhe per IAL te tjere ne vendin tone. <i>(Evidenca 13)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.	IAL disponon rregullore te vecante ne lidhje me kriteret e kandidateve dhe perzgjedhjen e personelit akdemik. Nga CV e stafit akademik te angazhuar ne kete program studimi ne pame se ato nuk ishin te gjitha ne perputhje me bazen ligjore ne fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore. Mendojme se duhen permiresuar CV e stafit akdemik me grada dhe tituj shkencore kryesisht ne fushen e stomatologjise. Kjo do te ishte e nevojshme qe mundesisht te jene edhe te pergatitur ne nenespecialitetin e duhur te stomatologjise per te cilin ata do te trajnojne kandidatete qe ndjekin kete program studimi. IAL eshte i ndergjegjshem per nje kerkese te tille he po punon me te gjitha mundesit qe disponon per te bere rregullime te shpejta dhe per te plotesuar te gjitha standartete e nevojshme ne kete drejtim. <i>(Evidenca 11)</i>
Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe	Dosjet e personelit akademik efektiv, me kontrate dhe personelit akademik ndihmes ishin te rregullta, prej te cileve 14 ishin personel akademik me kontrate por duhen permiresuar kontratat e personelit akademik me kontrate. Keto procedura jane te respektuara per te gjitha kategorite e personelit akademik, per udheheqesit e programit, te lendeve e moduleve, ashtu edhe per tutorët qe ndjekin e monitorojne zhvillimin e praktikave profesionale te studenteve.

Naxmi Koci
Arso

[Signature]

<p>vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p><i>(Referuar vizites ne IAL)</i> <i>(Aneksi 38- Stafit akademi i angazhuar ne kete program studimi)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Per sa i perket numrit optimal te stafit ai eshte 7 i cili perputhet me ligjin numer 80/2015 per arsimin e larte ku njesia baze ka jo me pak se tre pedagoge me grade shkencore ose titull akademik. U vu re se kishte nje angazhim mjaft te mire nga personeli akademik per permbushjen e objektivave te ketij program. Por ne kete program duhet permiresuar numri i stafit me grade shkencore apo titull akademik ne fushen e stomatologjise, per te cilin eshte deficitare.</p> <p><i>(Aneksi 61,62-Te dhena per personelin akademik)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>IAL anagazhohet per kualifikimin e vazhdueshem dhe zhvillimin e metejshem profesional te personelit qe mbulon dhe administron kete program studimi nepermjet permiresimit te medotave te mesimdhënies dhe perdorimit te teknologjive te reja.</p> <p>Nje ndihmese te madhe per kete problem ka dhene bashkepunimi me Universitetin “Ismail Qemali” dhe Universitetin e Fogias ku jane realizuar veprimtari te perbashketa shkencore, seminare promocionale, leksione te hapura si dhe punime shkencore te botuara ne buletin shkencor REALD apo ne revista te tjera brenda dhe jashte vendit etj. Mendojme qe ne buletin shkencor REALD duhet te kete me shume punime shkencore ne fushen e stomatologjise ne pergjithesi dhe aq me shume ne programin e ri “Ndihmes Dentar”.</p> <p><i>(Marreveshja e bashkepunimit me Univ I.Qemali dhe Univ e Fogias)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se, KU “Reald” siguron mjedise te mjaftueshme dhe te pershtatshme mesimore per zhvillimin e mesimdhënies ne kete program. Auditoret jane te bollshem, te plotesuar relativisht mire, konkretisht per zhvillimin e</p>

Naxmi Koci
Arso

[Signature]

<p>të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>leksioneve, seminareve laboratoreve dhe praktikave duke u pershtatur me numrin e studentave të këtij program.</p> <p><i>(Referuar vizites ne IAL- vëzhgimi i ambjenteve)</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Bazuar në vizite në institucion konstatojmë se, mjediset mësimore si klasat laboratore, studio, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit duke garantuar realizimin e plotë të procesit mësimor teorik dhe praktik dhe duke siguruar cilësinë e mësimdhënies dhe të mësim nxënies. Kolegji zotëron godinën kryesore ku zhvillohet program me karakter profesional “Ndihmes Dentar” i cili disponon sipërfaqet e mëposhtme:</p> <p>Kati për dhe me sipërfaqe 980 m²</p> <p>Kati i parë me sipërfaqe 1043 m²</p> <p>Kati i dytë me sipërfaqe 1043 m²</p> <p>Total i Sipërfaqes = 3066 m²</p> <p><i>(Evidenca 34) (Referuar vizites ne IAL- vëzhgimi i ambjenteve)</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparataturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Sipas natyrës specifike të këtij program IAL ka të gjithë infrastrukturën e nevojshme me aparataturat dhe mjetet përkatëse për aftësimin teorik dhe praktik pershtatur në objektivat formuese të programit të studimit në tërësi. Risi është klinika dentare e cila është bashkëkohore me 7 poltrona, me aksesoret e nevojshme për kryerjen e vizitave, egzaminimeve stomatologjike dhe praktikave profesionale, për të cilët drejtuesit e IAL garantojnë venien në punë në kohën e fillimit të procesit mësimor. Gjithashtu kishte dhe dhomë me manikinet përkatëse për realizimin e praktikës mësimore në fushën e mjeksisë <i>(Evidenca 34)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ëve të studimit që ofron.</p>	<p>IAL ka një laborator të teknologjisë së informacionit të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. Stafit akademik dhe studentët kanë akses të plotë për të shfrytëzuar sallën e informatikës me server qendror. Laboratori i ri i IT që ka në funksion 30 kompjutera. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë në sipërfaqe optimale dhe bashkëkohore. Ato janë të pajisura me kompjuter dhe videoprojektor për të lehtësuar procesin mësimor.</p> <p>Studentët mund të punojnë si në laborator, ashtu edhe në bibliotekë për realizimin e detyrave të kursit.</p> <p><i>(Evidenca 34) (Referuar vizites ne IAL- vëzhgimi i ambjenteve)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe</p>	<p>IAL ka marrëveshje bashkëpunimi me disa klinika dentare të qytetit të Vlores gje e cila u jep mundësi studentave për përgatitjen dhe realizimin e praktikave mësimore.</p> <p>Praktikat mësimore realizohen në institucionet private ose publike me të cilët KUR ka marrëveshje. Në kolegjin studentët mund të diskutojnë me tutorin e praktikave mësimore, apo pedagogët e tjerë të programit të</p>

Naxhi Koci
Arbaci

veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	studimit, por orët e praktikës. <i>(Evidenca 25)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Referuar dokumentacionit të dërguar nga institucioni dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se KUR vë në dispozicion të gjithë studentëve të regjistruar pranë këtij kolegji një sallë bibliotekë. Studentet dhe pedagoget kane akses te plote qe te studiojne bibloteken cdo dite te javes nga ora 08-00:16-00, madje bibloteka qendron e hapur edhe ditet e shtuna per t'ju ardhur ne ndihme studentave. Literatura fizike e biblotekes ishte e mjaftueshme per formimin e pergjithshem te ketij program por mungonte literatura e plote Stomatologjik, vecanerisht ajo ne gjuhen shqipe. Per kete arsye, GVJ i rekomandon IAL-se se duhet te siguroje fondin e nevojshem te teksteve per kete program studimi dhe per programet e tjere te fushes se stomatologjise. <i>(Evidenca 34) (Evidenca 37)</i>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Per sa i perket literatures ajo ishte e bollshme por nga takimi i realizuar ne bibloteken e institucionit rezultoi se mungon literatura fizike mesimore baze ne gjuhen shqipe ne fushen e stomatologjise. GVJ rekomandon qe Institucioni te marre masat per te shtuar numrin e kopjeve fizike ne bibliotekë te cilat do ti vijne ne ndihme studenteve te ketij programi studimi, por edhe programeve te tjeter ne fushen e stomatologjise. <i>(Evidenca 34) (Mbeshtetur ne viziten ne IAL)</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e	Shfrytezimi i biblotekes dhe paisjeve kompjuterike ishte pa pagese per studentet dhe stajin akademik. Gjithashtu ato kane akses ne bobloteken online. https://unireald.edu.al/wpcontent/uploads/2018/05/listaelibraveonlineanglisht.pdf Institucioni investon në shtimin e zërave në bibliotekë në varësi të

Naxmi Koci
Arso

[Signature]

zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	kërkesave të pedagogëve të lëndës. Gjatë zhvillimit të mesimit online në semestrin e dytë, IAL ka përdorur platformën Google Classroom, e cila ju ka ardhur në ndihmë studentëve për të ndjekur leksionet			
Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.	Institucioni nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka nënshkruar me një sërë institucioneve private dhe publike ndikon në formimin teorik, praktik dhe profesional të studentëve. IAL bashkëpunon dhe me IAL publike (Universiteti Ismail Qemali Vlorë). Por duke qenë se programi është i ri duhet bërë ndryshimet eventuale në program apo në kurrikul për përmirësimin e cilësisë së mesimdhënies. <i>(Evidenca 26)</i>			
Kriteri 5. Institucioni parashikon kostot financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.	Raporti financiar hartohet nga zyra e financave të IAL e cila administrohet gjithashtu dhe listat pagesat e stafit akademik, ndihmes akademik për çdo vit në bazë të buxhetit kjo zyrë garanton përfundimin me sukses të këtij programi. <i>(Evidenca 41) (Evidenca 68) (Evidenca 69)</i>			
Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në KUR, GVJ konstatoi se institucioni harton raporte financiare të kostove sipas programeve të studimit në nivel kolegji. IAL siguron dhe garanton mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative që janë në funksion të realizimit të programit të studimit duke garantuar qëndrueshmërinë financiare në përfundim me sukses të këtij programi. <i>(Evidenca 41)</i>			
Shkalla e përmbylljes së standardit	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Naxhi Koci
Arso

[Signature]

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kritere të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>IAL ka procedura te miratuara per studentet qe nga marrja e statusit te studentit deri ne diplomimin e tyre. Keto procedura jane te parashikuara ne rregulloren perkatese te miratuar nga senati akademik. Keto procedura garantojne barazine dhe te drejta te njejta per te gjithë kandidatet per studente. Studentet e ketij programi studimi pranohen ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe aktet e vecanta rregullatore. statusi i studentit fitohet qe me rregjistrimin e tij ne kolegji. Te drejtat dhe detyrimet e studenteve percaktohen ne baze te ligjit nr. 80/2015 “Per arsimin e larte dhe kerkimin shkencorne Republikën e Shqiperise”, ne statutin dhe rregulloren e brendshme te IAL. Status ii studentit perfundon me marrjen e diplomes perkatese si dhe ne raste te ndryshme te crregjistrimit te tyre nga ky kolegji per arsyet e meposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Me urdher te dekanit bazuar ne kerkesen e studentit per crregjistrim ne formen e nje deklarete te perpiluar para nje noteri • Me urdher te dekanit kur ka humbur kushtet dhe kriteret per te drejten e studimit. • Kur denohet me burgim per nje krim te rende. • Kur braktis pa shkak studimet • Me urdher te dekanit per shkelje te rende ose te perseritur te kesaj rregulloreje ose te rregulloreve te tjera <p><i>(Evidenca 5-neni 62-79)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>IAL harton dhe publikon kriteret per perzgjedhjen e kandidateve ne programet e studimit me karakter profesional per studente te cilat i dergon ne MASR para fillimit te vitit akademik. IAL pergatit dhe shperndan postera per publikun ne lidhje me programet e studimit qe ofron.</p> <p><i>(Evidenca 39) (Evidenca 40)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Institucioni ka nje informacion te plote dhe te hollësishem ne lidhje me procedurat e perparimit akademik te studenteve. Ky informacion eshte i aksesueshem ne faqen elektronike te IAL. Kandidati duhet te kete perfunduar shkollen e mesme brenda ose jashte vendit, diplomën e shkolles se mesme te njohur nga struktura perkatese e MASR dhe pa kriter perjashtues persa i perket mesatares se notes.</p> <p><i>(Evidenca 7)</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për</p>	<p>IAL i informon hollësisht studentet per strukturen, organizimin dhe kohezgjatjen e programin e studimeve me karakter profesional.</p>

Naxmi Koci
Arbaci



strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	https://unireald.edu.al/kohezgjatja-e-studimeve/ Gjithashtu studentet dhe kushdo tjetër i interesuar për programet e studimit në IAL informohen edhe nepermjet posterave që shperndan IAL në shkollat e mesme në takime me maturantët. Gjithashtu ajo informon studentet mbi mundësinë e studimit dhe për orientimin e tyre drejt tregut të punës.			
Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	IAL ka në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese etj. Ky informacion është i plotë, i përditësuar duke u bazuar në organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Ky informacion është i aksesueshëm në faqen elektronike të IAL. <i>(Evidenca 66) (Evidenca 40)</i>			
Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni që marrin studentet në lidhje me programin e studimit është lehtësisht i arritshëm prej tyre si në ambientet e brendshme të institucionit, ashtu edhe në distancë prej tij. Informacioni i mesipër gjendet në faqen elektronike të IAL. www.unireald.edu.al			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.	Sekretaria mesimore bën regjistrimin e studentëve të cilat i ka të pasqyruara në regjistrat përkatës kundrejt legjislacionit në fuqi. Studentët në momentin e regjistrimit nënshkruajnë kontratën e studimeve, e cila ka gjithë detyrimet ndërmjet paleve nënshkruese. Në regjister janë të dokumentuara të dhënat personale të studentit të këtij programi të cilat fillojnë me datën e regjistrimit, të dhëna për shkollën e mesme që ka kryer, matrikullimin, transferimin, e deri të data e diplomimit. Gjithashtu IAL disponon edhe regjistrin e vlerësimit të studentit gjatë gjithë periudhës që ndjek këtë program. Këto regjistra janë të administruar nga

Naxmi Koci
Arso

	<p>sekretaria mesimore dhe te plotesuar sipas legjislacionit ne fuqi.</p> <p>Nga dokumentacioni i vene ne dispozicion dhe nga vizita ne IAL, GVJ konstaton se KU "Reald", nuk disponon nje sistem menaxhimi/informimi digjital institucional, i cili t'ju vij ne ndihme studenteve te ketij programi.</p> <p>Dokumentacini ruhet vetem ne kopje fizike.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>I gjithë stafi akademik, ndihmes-akademik dhe administrativ ka te depozituar ne zyren e burimeve njerezore te IAL gjithë dokumentacionin perkates. Ky dokumentacion pasqyrohet nepermjet dosjes personale e cila ne brendesi ka CV, diplomat te noterizuara, certifikatat e trajnimit, deshmine e penalitetit, kontraten e punes, fotokopje te ID, deshmi te specializimit, deshmi te gjuheve te huaja.</p> <p>GVJ konstaton se IAL nuk ka ne perdorim nje sistem te brendshem nepermjet te cilit administrohet informacioni, dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit akademik, personelit ndihmes akademik, personelit administrativ dhe te partnerëve te angazhuar ne realizimin e programit. Ky informacion perpunohet dhe administrohet nga personeli pergjegjes i burimeve njerezore dhe sekretaria mesimore sipas procedurave te percaktuara në rregulloret perkatese.</p> <p><i>(Evidenca 57) (Evidenca 64) (Evidenca 65) (Evidenca 9)</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Informacionet per te gjithë personelin dhe studentet e programit te studimit mund te verifikohen ne linkun e meposhtem.</p> <p>https://unireald.edu.al/stafi-akademik/#cv-e-pedagogeve-unireald.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nepermjet platforms www.unireald.edu.al, eshte mundesuar ne kete institucion komunikimi interaktiv dhe shkembimi i informacionit nepermjet personelit akademik dhe studenteve. Gjithashtu ne IAL perdoren edhe platforma te tjera komunikimi si google classroom.</p> <p>GVJ konstaton se IAL nuk ka ne përdorim nje sistem qe monitoron ne kohe reale aktivitetin akademik e administrativ dhe mundeson raportime individuale dhe te dhena ne kohe reale per organet drejtuese dhe titullaret. Ky informacion perpunohet dhe administrohet nga zyra e burimeve njerezore dhe sekretaria mesimore qe përpunojne dhe pergatisin informacionin e kerkuar per organet drejtuese dhe titullaret e IAL.</p> <p><i>(Evidenca 60,61,62,63)</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Cdo student ka adresen e tij ne sistemin elektornik/rrjetin e brendshem te komunikimit me email (emer.mbiemer@unireald.edu.al) qe komunikon me stafin akademik dhe joakademik ne cdo kohe. Stafi akademik raporton ne kohe reale, lidhur me procesin akademik online duke vene ne dispozicion kodin e tij te platformes. Ne kete menyre pergjegjesi i njesise nga kompjuteri i tij mund te ndjek live zhvillimin e procesit mesimor.</p>

Naxmi Koci
Arbaci

BM

Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet qe lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen ne faqen e internetit ne dy gjuhe-shqipe dhe angleze. https://unireald.edu.al/en/ dhe https://unireald.edu.al/it/fakulteti-i-shkencave-mjekesore/			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kritere të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>IAL harton dhe zbaton kriteret dhe procedurat, të cilat janë të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. Ato janë të publikuara në faqen elektronike të IAL.:</p> <p>https://unireald.edu.al/studentet/ dhe https://unireald.edu.al/si-te-aplikojme/. Për sa i përket programit profesional Ndihmes Dentar kriteri i pranimit është perfundimi i shkolles së mesme ose e barazvlefshme me të brenda ose jashtë vendit, (e njehesuar nga institucionet shqiptare), pavarësisht nga nota mesatare e cila nuk është kriter përzgjedhje për të ndjekur këtë program studimi.</p> <p><i>(Evidenca 7)</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat nga regjistrimi deri në diplomimin e studentit garantojnë barazine dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studente dhe studentët e programit të studimit. Politikat e përzgjedhjes së studentëve nuk kanë karakter diskriminues. Ato janë të njëjta për të gjitha kategoritë e studentëve pavarësisht origjinës, shtetësisë kombësisë racës etj.</p> <p><i>(Evidenca 7)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>IAL për çdo vit akademik harton dhe publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit të cilat i dërgon dhe në MASR përpara çdo fillim viti. Ky program nuk ka kritere të veçanta për pranimin e studentëve me përjashtim të perfundimit të shkolles së mesme.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat</p>	<p>IAL vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Informacioni është i aksesueshëm në faqen elektronike të IAL. Studenti kalon nga viti i parë në vitin e dytë kur ka siguruar të paktën 30 kredite të vitit të parë. Studenti pasi shlyen detyrimet akademike (të gjitha provimet) lejohet të hyjë në provimin e diplomes. Nëse nuk i ka shlyer ato, duhet të shlyej dhe</p>

e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	te futet ne sezonin e provimeve te vjeshtes. Gjithashtu studenti lejohet te hyj ne provimin e diplomes pasi ka fituar te gjitha kreditet e parashikuara ne programin mesimor. <i>(Evidenca 5) (Evidenca 67)</i>			
Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.	IAL informon studentet ne lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit te diplomes dhe diplomimit te tij. Per te fituar te drejten e hyrjes ne provimin perfundimtar, studenti duhet te kete marre vleresime pozitive ne te gjitha lendet mesimore dhe ne praktike duke siguruar kreditet mesimore te nevojshme. Ndersa per te fituar diplomen profesionale (Ndihmes Dentar) studenti duhet te jap me sukses provimin perfundimtar ne [erputhje me kreditet e percaktuara ne planin mesimor. <i>(Evidenca 7)</i>			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Para fillimit te vitit akademik IAL organizon takime neper shkollat e mesme me studentet maturante per ti njohur ato me programet e studimit qe ofron ky institucion. Keto takime zhvillohen rreth muajit Shkurt sipas nje kalendari te miratuar nga MASR. Studenteve u vihen ne dispozicion postera, broshura, ne te cilat mund te marrin informacion te plote lidhur me keto programe qe ofron IAL, si dhe tarifat perkatese per cdo program. Gjithashtu informacioni me i plote jepet ne faqen e IAL: https://unireald.edu.al/studentet/ . <i>(Evidenca 40)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.	IAL informon ne menyre te hollesishme studentet per strukturen, organizimin dhe kohezgjatjen e programit te studimeve dhe ve ne dispozicion te tyre informacionin dhe dokumentacionin e posacem per modulet, lendet, permbajtjen dhe veprimtarine formuese te programit te studimit me karakter profesional si dhe per infrastrukturen e institucionit. Gjithashtu studentet dhe familjaret e tyre mund te marrin informacion nepermjet faqes se IAL ne linkun e meposhtem: https://unireald.edu.al/pse-unireald/ . <i>(Evidenca 14)</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese	IAL informon studentet mbi praktikat profesionale ne kuader te realizimit te programit te studimit, partnered dhe institucionet bashkepunuese ku parashikohen te realizohen si dhe mundesite e punesimit duke i orientuar drejt tregut te punes. Per kete problem IAL ka nenshkruar mareveshje bashkepunimi me klinika te ndryshme dentare ne qytetin e Vlores per

Naxmi Koci
Arso

[Signature]

ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	realizimin e plote të praktikave mesimore. Ky informacion ju jepet studenteve nga fillimi i vitit akademik deri në përfundim të programit. Për këtë problem IAL ka dhe klinikën e saj dentare me ambientet përkatëse si dhe laboratorin e stomatologjisë. Studentët kanë të drejtë të zgjedhin klinikën ku ato mund të realizojnë praktiken për realizimin e programit. <i>(Evidenca 26)</i>			
Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Informacioni i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën është i aksesueshëm në faqen elektronike të IAL në linkun e mëposhtem https://unireald.edu.al/studentet/ Në javën e parë të orientimit studentët informohen nga departamenti mbi zhvillimin dhe organizimin e programit mësimor, logjistikës, infrastrukturën e programit të studimit. Gjithashtu studentët informohen në javën e parë të mesimit, gjatë prezantimit të secilës lende dhe syllabusit përkatës nga pedagogu.			
Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni në lidhje me programin e studimit është lehtësisht i arritshëm nga studentët si në institucion ashtu edhe në distancë prej tij. Ky informacion jepet në faqen elektronike të IAL të "Guida e studentit" në linkun e mëposhtem https://unireald.edu.al/studentet/#guida-studentit .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.	Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në këtë program që në fillimin e tij deri në ditët e sotme. Në fund të çdo viti akademik IAL dërgon informacion në MASR për numrin e studentëve dhe të dhënat përkatëse të tyre për programin e studimit Ndihmes Dentare nuk kemi asnjë student të diplomuar sepse është program i ri. <i>(Evidenca 67) (Evidenca 29)</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin	Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit me karakter profesional, tërheqjet nga programi si dhe largimet para përfundimit të programit të cilat janë të dokumentuara në regjistrat përkatëse. Në vitin e parë akademik 2018-2019 rezultojnë 17 studentë të regjistruar dhe 1 i cregjistruar për mungesë

Naxhi Koci
Arso

[Signature]

me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	dokumentacioni. Viti i dyte 2019-2020 regjistruar 21 dhe 2 te cregjistruar. <i>(Evidenca 23)</i>			
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.	Te gjitha te dhenat e studentave administrohen nga sekretaria mesimore e IAL e cila disponon regjistrat perkates per kete program studimi me te dhenat personale te studentit, te cilat fillojne me daten e regjistrimit, diploma e shkolles se mesme, matrikullimin etj. Gjithashtu sekretaria disponon edhe regjistrin e vleresimit te studentit me note gjate gjithe periudhes qe ndjek kete program. Ajo cka konstaton GVJ eshte se nuk ka nje sistem online ose sistem te menaxhimit te te dhenave te studenteve. <i>(Evidenca 9)</i>			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Te dhenat statistikore te studentave jane lehtesisht te aksesueshme dhe te verifikueshme nga personat e autorizuar, por vetem ne kopje fizike GVJ konstaton se IAL nuk ka ne perdorim nje sistemi menaxhimi informatik te brendshem ku ruhen, administrohen dhe perpunohen te gjitha te dhenat e studentëve, perfshire dhe rezultatet e ecurise ne programin e studimit, gjenerimin e raporteve të ndryshme statistikore. Si e tille siguria e informacionit që administrohet në IAL eshte e cenuar dhe jo lehtesisht e verifikueshme nga personat e autorizuar. http://www.ascal.al/apps/hei.php			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Ne fund te vitit akademik IAL harton raport te detajuar ne nivel institucional te cilesise se hyrje-dalje te studentave i cili dergohet ne MASR brenda muajit Dhjetor te vitit pasardhes akademik. Gjithashtu ky raport pasqyrohet ne faqen e IAL dhe eshte i aksesueshem per persona te interesuar. Nga ana e IAL duhet te parashikohen masa te metejshme pervec bashkepunimin me partneret per praktikat profesionale dhe aftesimin profesional të tyre si pjesemarrjet ne panaiet e punes, ne aplikime dhe pjesemarrje ne projekte kombetare dhe nderkombetare. <i>(Evidenca 29)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon	Ne statutin e IAL eshte percaktuar qe nje prej antareve te senatit

Naxmi Koci
Arso

[Signature]

<p>përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>akademik të jete student. Nderkohe edhe për vetëvlerësimin e brendshëm për arsye akreditimi apo në raportet e NJSBC pjesë përberëse e këtyre grupeve të punës janë edhe studentët. Në Statutin e KUR (Neni 10, pika 2) është e përcaktuar që një prej anëtarëve të Senatit Akademik është student. Edhe në procese të tjera vendimmarrëse janë përfshirë studentët.</p> <p><i>(Aneksi: 2_ Statuti i KUR)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në Statutin e IAL (neni 37) është e përcaktuar që një prej anëtarëve të NJSBC-së është anëtar i Këshillit Studentor.</p> <p>Po kështu, edhe në grupin e brendshëm të vlerësimit (GBV) njeri prej anëtarëve është student.</p> <p>Edhe në rregulloren e sigurimit të brendshëm të cilesisë është anëtar një përfaqësues i këshillit studentor gjë që u konfirmua gjatë takimeve të realizuara në këtë institucion.</p> <p><i>(Evidenca 2) (Evidenca 8)</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesëme të mëparshme.</p>	<p>Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit institucioni bazohet në ngarkesën akademike të studentëve dhe parashikimin e procedurave jo burokratike të përparimit të studentëve gjatë programit. Përsa i përket transferimit të studentëve midis programeve të të njëjtit cikël, në universitete të tjera apo edhe brenda universitetit, mendojmë se aktualisht është e vështirë të realizohet sepse programe të tilla janë të pakta në Shqipëri dhe pa ndonjë eksperiencë të mjaftueshme, vecanerisht për këto programe.</p> <p><i>(Evidenca 6)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>IAL ka caktuar një koordinator për ndjekjen e ecurisë të programit dhe bashkëpunimit me studentët lidhur me propozimet apo kërkesat e tyre, por për programin e studimit profesional “Ndihmes Dentar”, duke qenë se është i ri, studentët nuk kanë dhënë sugjerime për rishikimin e tij.</p> <p><i>(Evidenca 29) (Evidenca 49)</i></p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësive/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e njësive apo pedagogut përkatës. Studenti ka të drejtë për të rishikuar testin, për ta ankuar lidhur me vlerësimin në rastet kur mendon se vlerësimi i tij është jo i drejtë. Nëse ka mosmarrveshje, studentit ka të drejtë të drejtohet me shkrim përgjegjësit të departamentit që mbulon lëndet përkatëse brenda 24h nga marrja e rezultetit të provimit. Në rastet e mosmarrveshjeve për zgjidhjen e ankesës, përgjegjësi i departamentit ve në dijeni dekanin. Ky i fundit brenda 24h ngrë një komision <i>Ad-hoc</i> i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit dhe përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. Procesverbalin e ri firmosur nga komisioni, i</p>

Naxhi Koci
Arbaci



	bashkengjitet procesverbalit te meparshem. <i>(Evidenca 2)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	IAL ka zyren e keshillimit te karriere dhe ALUMNI e cila eshte ne sherbim te informimit te studenteve, kjo zyre vepron ne baze te detyrave te percaktuara ne rregulloren e keshillimit te karrieres te miratuar nga Senati Akademik. Ajo cka GVJ konstaton nga dokumentacioni i vene ne dispozicion dhe vizita ne IAL, rezulton se kjo zyre nuk ka realizuar asnje aktivitet per studentet e ketij programi studimi. Gjithashtu konstatojme se kjo zyre nuk ka nje kalendare te percaktuar per aktivitetet qe ka realizuar ose do te te realizoje edhe me studentet e programeve te tjera qe ofron IAL. <i>(Evidenca 5) (Evidenca 12)</i>
Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Bazuar ne dokumentacionin e vene ne dispozicion, perkatesisht ne rregulloren, zyra e keshillimit te karrieres punon per sigurimin e punesimit te studentave pas diplomimit. Ne rregullore thuhet se kjo zyre eshte ne dispozicion te studentave per ti ndihmuar qe ato te zgjedhin orientimin dhe programin e duhur ne perputhje me prirjen, talentin dhe planin individual te karrieres. Kjo zyre e zhvillon aktivitetin e saj qe ne regjistrimin e studentit, ecurine akademike dhe profesionale deri ne periudhen pas diplomimit duke ofruar mundesi te punesimit te tyre ne te ardhmen, por ajo qe GVJ konstatoi gjate vizites eshte se nuk eshte realizuar ndonje aktivitet i tille per studentet e ketij programi studimi. <i>(Evidenca 12)</i>
Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Procesi i zhvillimit dhe keshillimit te karrieres eshte i lidhur ngushtesisht me formimin akademik te studenteve, mundesine e punesimit te tyre duke formuar nje profil akademik individual i cili do tju sherbeje ne karrieren e neserme por edhe ne studimet e metejshme. GVJ rekomandon qe kjo te rrise numrin e aktiviteve, hartoj nje plan/agjendete qarte per realizimin e aktiviteve te ndryshme te cilat do ti vijne ne ndihme jo vetem studenteve te ketij programi studimi, por edhe studenteve qe ndjekim programe te tjetea ne kete IAL. <i>(Aneksi 15_ Rregullorja e Keshillimit te Karrieres)</i>

Naxmi Koci
Arbore

[Signature]

<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>Zyra e zhvillimit të karrierës duke u koordinuar me seksionin ALUMNI, fal bashkepunimeve të vazhdueshme me sektorin publik dhe privat, ajo ndjek studentat edhe pas diplomimit duke mbledhur dhe përpunuar të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të këtij programi studimi, duke ja vënë në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve përkatëse me qëllimin për përmirësimin e shkallës së cilësisë së punësimit të tyre.</p> <p><i>(Evidenca 24)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Ndhmës Dentar” të Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “REALD.”

Pika të forta:

1. Kolegji Universitar REALD, ka bërë përgatitje të mira për realizimin me sukses të programit të studimit për Ndhmës Dentar. Për këtë qëllim kohët e fundit është ngritur një klinikë stomatologjike me pajisje bashkëkohore dhe gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe që ka 7 unite dentare ku mund të punojnë lirisht 14 deri 20 studentë të mbikqyrur.
2. IAL ka mjedise të bollshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore teorike dhe praktike të këtij programi si: auditore për leksione, seminare, laborator etj.
3. IAL ka vënë në efikasitet laboratorin dentar me manekinë për praktika paraklinike si dhe të pajisur me aksesoret përkatës që simulojnë praktikën me të sëmurë dhe që janë enkas për këtë program studimi.
4. Realizimi i programit profesional për “Ndhmës Dentar” është një risi që mbështet zhvillimin e stomatologjisë ku ka prurje me shumicë të specialistëve me arsim të lartë, por që ka mungesa të specialistëve ndihmës që kërkon shërbimi i kohës.

Pika të dobëta:

1. Ka nevojë të bëhen përmirësime në drejtim të rritjes së numrit të personelit akademik me grada dhe tituj shkencor dhe specialistë të fushës së stomatologjisë.
2. Duhet të përmirësohen më tej syllabuset e lëndëve, duke i ndarë në mënyrë korrekte sipas kërkesave të ligjit në disiplina bazë, karakterizuese, ndihmëse dhe me zgjedhje.
3. Përmirësimi i programit duhet të përfshijë edhe rregullimin e raportit të oreve mësimore midis oreve teorike dhe atyre të praktikave profesionale sipas kërkesave të standartit shtetëror për cilësinë e mësimdhënies.
4. Nuk janë zbatuar në mënyrë korrekte kërkesat e ligjit dhe të rregullores së institucionit në aktivitetin e zyrës së këshillimit të karrierës

5. Të pasurohet biblioteka me literaturë shqip si dhe atë të fushës së stomatologjisë, sidomos ajo për programin e studimit për Ndhimës dentar dhe të Asistencës dentare.

REKOMANDIME:

1. Të bëhen përmirësime në përbërjen e stafit akademik me synimi që të realizohen detyrimet ligjore për përbërjen e Departamentit të stomatologjisë, ku duhet të marrin pjesë specialistë të fushës, pedagogë me tituj e grada shkencore dhe për karakterin profesional të programit edhe specialistë të Stomatologjisë që kanë kryer SPA në profile si Kirurgjia, Terapia, Protetika etj.
2. Brenda hapësirave ligjore për ndryshimin deri në masën 20% të kurikulës së programit të studimit të bëhen ndryshime në lëndët me karakter detyrues, ku të vihen si lëndë detyruese lëndët si: gjuha latine dhe Kirurgjia Stomatologjike që deri tani figuronë si lëndë me zgjedhje. Ndërkohë lëndë si Shkrimi akademik që deri tani është detyruese, të kalohet në lëndë me zgjedhje.
3. Të bëhen përmirësime në programin e studimit duke shtuar praktikat profesionale, pasi ky është një program me karakter profesional. Përmirësimet të çojnë drejt raportit të orëve praktike deri në masën 50% të programit dhe të orëve në praktikat profesionale dhe jo me pak se 25-30% të orëve të programit.
4. Te ngrihet në nivelin e standartit ligjor dhe të kerkesave të rregullore organizimi dhe funksionimi i zyres së këshillimit të karrierës.
5. Të pasurohet biblioteka me literaturë shqip të fushës së stomatologjisë. Për ndihmës dentar dhe ajo që lidhet me asistencën në fushën e stomatologjisë.

Conclusions and findings on the evaluation of the Study program with professional character “Assistant Dentist” of the Higher Education Institution, University College “REALD”

Strength:

1. University College REALD has made good preparations to successfully achieve the Study Program for Assistant Dentist. To this end, a Dentistry Clinic has recently been established with contemporaneous equipment and the entire needed infrastructure containing 7 Dental Units where 14 to 20 supervised students may freely work.
2. Higher Education Institution has spacy premises to ensure the development of theoretical learning, and practical activity like auditoriums, laboratories and seminars.
3. Higher Education Institution has put in full efficiency the dental lab with samples for paraclinical practices, equipped with respective accessories which stimulate the practices with sick people and which could be considered as special purpose vehicle for this Program.
4. The Accomplishment of the professional program for Assistant Dentist is a novelty, which supports the proliferation of dentistry where on the one hand, there is a large pool of higher education specialists and on the other hand, e noted lack of other resources like assistant specialists who are required at present.

Weaknesses:

1. There is need to make improvement in regards to the increase of academic staff holding scientific titles and specialists in dentistry field.
2. The curricula syllabus must be further improved by dividing those, in strict pursuance of the law requirements, into characterizing, supportive and optional or facultative syllabus.
3. The improvement of the program must include even the balance of academic hours between theoretical hours and those of professional practice, as per the state standard requirements for the improvement of the teaching process.
4. The requirements of the law and those of the institution regulation about the activity of the career advisement office are not correctly met.

5. The library must be enriched with Albanian literature and that of the dentistry area, in particular for the Study Program for Assistant Dentist and Dentistry Assistance

RECOMMENDATIONS:

1. Improvements should be made in the composition of the academic staff with a view to perform the legal duties concerning the composition of the Dentistry Department, where specialists, lecturers, instructors with scientific titles must be involved. As regards the professional character of the Program specialists of the Dentistry who have performed SPA in areas of Surgery, Prosthetic Therapy etc. should be involved as well.
2. Within legal discretion exercised for the alteration up to 20% of the Study program's curricula, changes should be made in subjects of the mandatory character, like Latin language and Dentistry Surgery, which at present is an optional subject. As regards other subjects like Academic Writing, recommendation would be to shift it in optional subject category.
3. Improvements to be made in the study program by increasing the size of professional practices, because this is a program of a professional character. Improvements must lead to the balance of practical hours up to the rate of 50% of the program and amount of hours in professional practices and in any event not less than 25-30% of the program hours.
4. The organization and functionality of the Career Advisement office to be improved to meet the legal standard and other requirements of the regulation.
5. The library must be enriched with Albanian literature and that of the dentistry area, in particular for the Study Program for Assistant Dentist and Dentistry Assistance.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	